

NËNTORI

ORGAN I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE
DHE ARTISTËVE TË SHQIPËRISË

Revistë e përmuajshme
letorraine artistike
shoqërore politike

Nr. 3, VITI XXXIII I BOTIMIT,
MARS, 1986

PËRMBAJTJA:

Plenum i Lidhjes së Shkrimitarëve dhe Artistëve të Shqipërisë 7

Për një pasqyrim më të thellë e të gjithashëm të realitetit socialist në pikaturë — Raport i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimitarëve dhe Artistëve, mbajtur nga anëtarë i Kryesisë, Mumtaz Dhrami 8

Nga diskutimet

ANDON KUQALI: Më shumë kërkesa cilësore në trajtimin e temës aktuale 32

KRISTAQ RAMA: Forma e bukur ushqen dhe rrit përmbajtjen 34

ZEF SHOSHI: Të bëjmë një jetë më intensive krijuese 35

FOTO STAMO: Njohja e jetës — domosdoshmëri për të dhënë tablonë e epokës sonë 37

DRITERO AGOLLI: Piktura jonë do të njohe arritje të reja 38

FATMIR HAXHIU: Jo pamje anësore, por veprat kompozicionale që japid me gjëresi dhe thellësi epikën e Luftës 42

AGIM FAJA: Kërkesa më të mëdha ndaj gjinisë së peizazhit 44

KUJTIM BUZA: Të ngremë tërë punën tonë krijuese në një shkallë më të lartë 46

45 VJET PARTI E PUNËS

Frymëzimet e Partisë dhe krijimi i vepgrave letrare-artistike

STERJO SPASSE: Epokë që më ndriçoi udhën e krijimtarisë 51

KRITIKA LETRARE-ARTISTIKE

RUDOLF MARKU: Zëra poetikë origjinalë — «Pragu i verës» poezi nga B. Mustafaj; «Emrat tuaj» poezi nga P. Zogaj; «Poezi» nga I. Zhupa	67
AGIM ISAKU: Misioni i poetit — Mbi vëllimin «Poezi» të Din Mehmetit	73

KRIJIME LETRARE

Tufa vjershash nga: SULEJMAN MATO, DEMIR GJERGJI, AQIF HYZA, KOSTANDIN DHAMO, AGIM HUSHI, SILVANA GJEBREA, KLARA KODRA, SHANE MUDA	79
SADIE AGOLLI: Vajza e pikturës — Në apartamentin' nr. 15, <i>tregime</i>	109
VALTER FILE: Bari i shtëpisë sime, <i>tregim</i>	127

TRADITA TË LETËRSISË E TË KULTURËS SONË

TONIN ÇOBANI: Revista «Bota e re», tri-bunë e letërsisë përparimitare të viteve 30 — Në 50-vjetorin e botimit të numrit të parë	141
---	-----

SHKOLLA DHE ARTI

THOMA QENDRO: Individualitetet në letërsi	161
PËRTEF KRUJA: Veprat në prozë të Hajnrit Hajnes	170

LETËRSI E HUAJ

Nga lirika botërore

Poezi nga: FERNANDO PESOA, KONDO AZUMA, HORHE LUIS BORHES, GABRIEL SELAJA, BÓ KAPELAN, PABLO NERUDA, PER HOJMOLT, HOSE AGUSTIN GOJTISOLO, ARTUR LUNDKVIST, MIGEL ERNANDES, SHARL FERDINAND RAMYZ, HUGO RODRIGES ALKALA, RÈNE GI KADU	185
--	-----

HARRI MYLISH: Kufiri, <i>tregim</i>	202
KATERINA SUZANA PRIÇARD: Fermeri i lumtur, <i>tregim</i>	225

KRONIKË E JETËS LETRARE ARTISTIKE

LIBRA

V. HYZOTI: «Konisk», poezi nga Aleks Çaci, — F. ALIMANI: «Gjaku i tokës», roman nga Ndoci Papleka	235
---	-----

ARTE FIGURATIVE

A. HADO: Ekspozita retrospektive e Piktoret të Popullit Sali Shijaku	237
--	-----

VEPRIMTARI

• Diskutim për festivalin e 24-t të këngës në RTV	240
• Diskutim për veprat e përkthyera në shqip të Hajnrit Bëlit	244

Kop. I: Sali Shijaku — «Kooperativistja nga Divjaka». Të këtij autori janë edhe ilustrimet e tjera të numrit.

Kryeredaktor: Dalan Shaplllo

Kolegjumi: Andon Kuqali, Eglantina Mandia, Fatmir Gjata, Jorgo Bulo, Simon Gjoni, Sterjo Spasse, Viktor Gjika, Xhevahir Spahi, Zef Gurakuqi (Sekretar i kolegjumit).

Plenumi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve

Më 27 janar në sallën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, zhvilloi punimet Plenumi i Lidhjes për problemet e pikturës. Merrnin pjesë anëtarët e Komitetit drejtues dhe kryetarë të degëve të Lidhjes në rrethe, piktorë, skulptorë, kritikë e studiues të artit, gazetarë etj.

Ndodheshin gjithashtu sekretari i Komitetit të Partisë të rrethit të Tiranës Pirro Lako, kryetari i Komitetit të Kulturës dhe Arteve Sefedin Çela e të tjerë.

Raportin e Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve «Për një pasqyrim më të thellë e të gjithanëshëm të realitetit socialist në pikture» e mbajti anëtarë i Kryesisë së Lidhjes, Skulptori i Popullit Mumtaz Dhrami. Pastaj diskutuan Andon Kuqali, Anastas Koständini, Kristaq Rama, Zef Shoshi, Foto Stamo, Dritëro Agolli, Fatmir Haxhiu, Razi Brahimë, Agustin Shyti, Agim Faja e Skënder Kamberi.

Në raport e diskutime u theksua se piktorët tanë, në dritën e mësimeve të Partisë, kanë krijuar veprave olera, sepse në themel të tyre janë zbatuar parimet e realizmit socialist, por zbulimi i dobësive u shërbën arritjeve të reja që kërkon koha. Ndaj dhe u diskutua me frysë kritike e autokritike mbi arritjet dhe rrugët për ngritjen e mëtejshme ideoartistike të pikturës sonë. Një pjesë të diskutimeve të plenumin po i botojmë me shkurtimë në këtë numër.

Në fund, konkluzionet e plenumin i bëri sekretari i Lidhjes, Kujtim Buza.

PËR NJË PASQYRIM MË TË THELLË E TË GJITHANSHËM TË REALITETIT SOCIALIST NË PIKTURË

Raport i kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve
dhe Artistëve, mbajtur nga anëtarë
i kryesisë, Mumtaz Dhrami

Mbledhja e këtij Plenumi të Lidhjes sonë të Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe diskutimi mbi problemet e pasqyrimit të realitetit socialist në pikturë, pa dyshim që do ndihmojë në ecjen më përparrë të arteve figurative. Problematika që përballon pikturën janë e realizmit socialist, nivelet që ajo ka arritur dhe detyrat që i dalin në stadin aktual, janë të lidhura me pë ato detyra që kanë artet tonë në përgjithësi, prandaj jehona e këtij diskutimi duhet të ndihet dhe në sektorët e tjerë të artit, si në muzikë e letërsi, ashtu dhe në forcat e tjera ekzekutive të skenës dhe ekranit. Të mbledhur pas punimeve të rëndësishme të Plenumit të 13-të të KQ të PPSH, është detyra jonë që atë frymë revolucionare për realizimin e planeve ekonomike, për shfrytëzimin e përvojës të vitit 1985 — vit i jashtëzakonshëm për vendin tonë, kur populli e Partia përballuan e kthyen në forcë dhimbjen për humbjen e udhëheqësit tonë të paharruar shokut Enver Hoxha, kur u përballuan vështirësítë nga thatësira e tejzgjatur dhe nga dimri i fortë — këtë frysme revolucionare ta trupëzojmë në krijimtarinë e vitit 1986 që është viti

i parë i pesëvjeçarit, viti i Kongresit të 9-të të Partisë së dhe 45-vjetorit të saj.

Aktualisht në mijediset tona artistike, në jetë, në ekspozita, në shtyp, në koncerте e kudo, bisedohet me préokupacion pér porositë e çmuara që shoku Ramiz Alia dha në takimin me shkrimtarë e artistë korçarë. Ne jemi bérë më të ndërgjegjshëm pér detyrat e mëdha që kemi përpara, pér të qenë në art «Flamurtarë të zbatimit të mësimeve të shokut Enver». Partia na dha porosinë edhe një herë që mos të krijojmë art me nivel mesatar, që të mos të ambientohemi me kërkesa mediokre, që shija jonë të jetë më e përparuar. Këto porosi duhen zbatuar në kohë dhe me nivel, sepse bashkekohësi ynë, pér veprën e ndritur që ai bën i udhëhequr nga Partia, pér jetën heroike që jeton, e meriton një art të lartë më nivele ideoprofesionale. Tani ne nuk i drejtohemi me veprën tonë një spektatori me formimin e dikurshëm, përkundrazi, nivel i tij të shënjësuar, ka kërkesa gjithënjë e më të larta, ai do të ndalet më tepër para veprës sonë, do të emocionohet e do të përfitojë më tepër, do të marrë përgjigjen e pyjetjeve që atë e shqetësojnë. Një art më nivel mesatar nuk i përballon dot këto kërkesa. Luftët kundër ambientimit dhe të kënaqurit me nivelin mesatar do ta bëjmë ne vetë. Kjo nuk është një detyrë që artistët tanë nuk mund ta përballojnë. Në radhët tona kemi forca shumë të afta, kemi shembuj dhe përvojë pune frymëzuese dhe mundësítë tona krijuese janë më të mëdha. Atò të gjitha duhen vënë në përdorim, por jo të nisur nga kërkesa mesatare, sepse ato do të na démtojnë artin tonë, nuk do të na nxisin në kërkime të reja, do të na mbajnë në vend, e do të na têrheqin pas, sic ka ndodhur në ndonjë rast.

Piktura jonë e realizimit socialist në trajtimin e temës së ditës, të ideve të kohës, të heronjve e të realitetit bashkëkohor, ka tashmë një traditë të mirë. Në themelin e shumë realizimeve dinjitoze, si tablotë «Vallëzon Shqipëria» të A. Buzës, «Diga e Drinit» e N.Zajmit, «Motive nga Divjakë», «Zëri i masës», «Kufitarët», «Ilia Kici Dashi» të S.Shijakut, «Punëtorët», «Dennoncimi i Traktatit të Varshavës» e portreti i shokut Enver Hoxha nga V. Kilica, «Shkolla e kantierit», «Punëtorët e shkrirjes» të D.Jukniut e I.Lulanit, «Naftetarët» e A.Shamit dhe «Punëtorët e Komanit» të A.

Mirukut, ose te motivet e reja në peizazhet e K. Buzës e V. Vasilit, apo te «Punëtori» i A. Bashës, «Buka e duarve tonë» e S. Kamberit, «Tornitorja» e Z. Shoshit, «Mëngjesi» i M. Saros e në shumë e shumë vepratë tjera, pulson një jetë e re, një përbajtje e fuqishme dhe emocionuese, një pikturë e gjallë e plot realizëm, pulson një mendim i partishëm dhe një gjuhë shprehëse komunikuese me masat e gjera të popullit. Gjithë kjo traditë e këto realizime, që nuk janë vetëm ato që përmendëm më sipër, po ku përfshihen dhe krijimet e F. Stamos, N. Zajmit, S. Kokobobos, B. Ahmetit, A. Domasejt, S. Capos, Ç. Cekës, M. Fushekati, H. Dhimos etj., dëshmojnë pér ato frymëzime të gjalla që i jep realiteti ynë socialist pikturës sonë të re. Në pikturën tonë të vitezave të fundit u vu re një ecje para e tablosë kompozicionale, kurse peizazhi, si gjini u kristalizua më mirë përmes shumë individualiteteve krijuese që tashmë e kultivojnë atë me sukses. Piktura, me përbajtjen e rrëndësishme e me nivelin cilësor gjithnjë në ngritje, e gjen tanë më mirë vendin në shumë mëdise socialkulturore, duke u bërë një forcë e mëdhe në edukimin ideoestetik të masave punonjëse.

Një shembull të mirë në përballimin e kësaj detyre dhanë artistët tanë me veprat e tyre në Muzeun Kombëtar Historik, në Muzeun e Gjergj Kastriotit, si dhe në disa mjedise festive apo të hoteleve e godinave karakteristike të turizmit. Kjo pu në e filluar me frymëzim vazhdon tani për muzetë historikë të qytetit B.Curri, të Burrelit, të stacioneve hekurudhore dhe do të kristalizohet pa dyshim me arritje akoma më dinjitoze në Pallatin e Kongreseve dhe në Muzeun për shokun Enver Hoxha, që do ngrihen në Tiranë. Një stad të tillë zhvillimi pikturna jonë monumentale e arriti sepse ajo bëri të veten një përmbytje të rëndësishme, për realizimin e së cilës ajo vuri në themel arritjet më të mira të traditës tonë si dhe nivelet e larta të piktureve së kavaletit. Ajo nuk u fut në momente anekdotike dhe as në grimcimet natyraliste, por duke përpunuuar kompozimet në forma figurative më lakonike, duke sintetizuar më mirë vizatimin e ngjyrën në shërbim të dhënies me emocion të ideve që ka kërkuar mjedisi ku ato janë vendosur. Arritjet e piktureve monumentale, mundësítë e saj shprehëse për t'u vënë në kontakt me masat e gjera të spektatorëve, kanë

shtuar së fundit dhe numrin e artistëve që po e lëvrojnë këtë gjini, të cilët patjetër do ta çojnë atë në arritje më cilësore në të ardhmen, duke lëvruar sidomos temat e aktualitetit, në të cilat piktura monumentalë është akomá shumë deficitare, sepse për to ka pasur dhe më pak porosi. Arritjet në pikturën monumentalë nuk do të ishin të mundura, pa marrë në konsideratë atë që ka realizuar piktura e kavaletit në pasqyrimin e realitetit socialist. Por nga ajo duhen mënjuanuar défektet që janë vërejtur në pikturën e kavalletit, si cekëtësia e skematizmi, pompoziteti e teatraliteti, apo fotografimi mekanik i jetës dhe epigonizmi e huazimet.

Në atë që është arritur, të bën përshtypje përpjekja për të kapur më gjerë realitetin, karakteri optimist dhe theksi patetik i zbulimit të tij, larmia e individualitetit krijues të mjaft artistëve. Në numrin e veprave më të mira ne vëmë re kërkesat për gjetjet e reja artistike, që burojnë nga një njohje më e thellë e jetës, nga mënjanimi i bagazhit skematik. Janë bërë tentativa të suksesshme për ta parë realitetin dhe fenomenet e figurat e tij në zhvillimin e vet revolucionar. Në ekspositat e viteve të fundit pjesa dërrmuuese e veprave kanë trajtuar temat e aktualitetit socialist. Shumë krijues kanë realizuar ekspozita vetjake me përshtypjet nga jeta e përditshme nga puna në miniera, në kooperativa e ferma bujqësore, në Metalurgjik apo në Koman. Këtë vit 65 artistë kanë shkuan në bazë për të krijuar atje e për të grumbulluar material nga jeta. Të gjitha këto kanë sjellë atë freskim jetësor në artet figurative, përmes motiveve të reja, përmes mjeteve të shkriftës e më të gjallë shprehëse, përmes përpunimit të gjinive të ndryshme. Kjo jetë e gjallë krijuese ka gjallëruar dhe atmosferën e ka shtuar se drën revolucionare që secili të punojë më mirë se sa ka punuar, që të sjellë nga jeta diçka më të re e që të realizojë vepra më me cilësi se më përparrë. Kështu, duke përmendur disa shembuj të mirë të trajtimit të aktualitetit socialist, dua të nënvízoj pozitën e drejtë ideoprosfionale të pikture-s sonë në përgjithësi dhe të theksoj rëndësinë e shikimit novator të këtij realiteti të ri nga artistët tanë. Njerëzit e punës që shohim te tabloja «Zëri i masës» i S.Shijakut gjjejnë veten jashtë zbulurimeve, po, të piktuuar bukur, ata sjellin

në tablo, në studio, në mentalitetin e krijuesit, një psikologji të re. Kompozimi me të papriturat e veta përfshi një eveniment të rëndësishëm në jetën e krijuesit. Artisti me mjeshtëri jep bukur atë që e lartëson figurën e tij, lidhjen me njerëzit e punës, me shijet, kërkosat e interesat e klasës puntore. I ulur plot meditime fisnike, pa asnjë krekosje, eshtë Bariu i B. Asllanit me duart e të cilit janë skalitur mbi dru inicialet: e dashura PPSH. Ai nuk i shkruan ato në një faqe mali, ato janë pjesë të jetës së tij, gjithçka në tablo eshtë e vërtetë dhe e materializuar, e përshkruar nga një lirizëm i thellë. Asnjë truk formalist, asnjë banalitet natyralist nuk gjen tek «Mëngjesi» i M. Saros; janë njerëzit e ditëve tonë me preokupimet e shqetësimet e tyre. Gjithë dritë e forcë me një gjuhë krejt tjetër artistike, i jep N. Progri kooperativistët te «Lajmet e mëngjesit». Të dashura e plot fisnikëri të përshkuara nga ngjyra harmonike, përmes një kompozimi të ekuilibruar, vinë drejt nesh kooperativistët e H. Nallbanit duke na rrezatuar dashurinë e artistit përfshi njerëzit e punës. Sa nerv e dramacitet gjëjmë tek «Elektrifikimi», apo «Minatorët» e D. Jukniut, aq patos e monumentalizëm na jep C. Ceka përfshi metalurgët e vet. Një jetë të téré bart portreti i Myslym Pezës i F. Stamos, gjithë poezi eshtë Malësorja e vogël e Z. Shoshit, M. Arapin e gëzon çdo mëngjjez i bukur i Tiranës çdo e papritur në dritën e ngjyrën e kryeqytetit tonë, ashtu siç na bëjnë të mendojmë përvitet e luftës e përfshi ditët tonë peizazhet e B. Ahmetit, apo të M. Tahellarit. Shembuj të tillë emocionues mund të sjellim nga piktura jonë, sepse ata janë futur në ndërgjegjen e spektatorit jo vetëm me përbajtjen e tyre të rëndësishme, por edhe me një mjeshtëri të lartë artistike.

Por, duke nënvizuar disa realizime dhe arritje të pikturesh sonë, ne nuk mund të mos vëmë re edhe një sërë mangësish e boshllëqesh, të cilat në disa ekspozita janë manifestuar në një numër veprash uniforme e pa ndonjë problematikë të thellë. Kjo është arsyesa pa diskutojmë në këtë plenum pikërisht këtë problem. Shoku Ramiz, duke na tërhequr vëmendjen kundër ndjenjës së vetëkënaqësisë, në takimin me shkrimitarë e artistë korçarë theksoi se kemi ekoma shumë vepra që nuk arrijnë të prekin dhe t'i mishërojnë si duhet problemet që përballoh shoqëria. Në numrin e

këtyre veprave pjesën dërrmuese e përbëjnë jo pak krijime që lundrojnë në ujra të mesme, që, siç thotë populli, «as ndezin, as shuajnë». Veprat të nivelit me-satar në pikture nuk flasin thjesht për një moment stabilizimi të arritjeve, sesa për mentalitetin e të kë-naqurit me pak e të ambientimit me krijime të nivelit mediokër, që bëhen pa emocione të fuqishme e janë të zhveshura nga preokupacioni për të thënë një fjalë të re novatore, por që kanë vetëm një objektion: të futen në ekspozitë, të jenë brenda me të gjitha «kérkesat», pa hapur telashe e diskutime. Kjo shije e të kë-naqurit me pak ka dëmtuar pikturen tonë në përgjithësi, po ka dëmtuar dhe krijimtarinë e ndonjë piktori që ka rënë në këtë klimë dhe është futur në rutinë, pa e kuptuar që kjo formë krijimtarie nuk është stabilizim i arritjeve e i afirmimit të personalitetit krijues, por është më tepër pajtim më skematizmin, manierizmin e komercializmin. Për dobësi të tillë janë kritikuar tablotë «Drejt fshatit», «Pusi i naftës», «Çeliku i parë shqiptar», «Në kantierin detar», «Ujita», «Të korrat», «Ndërrimi i turneve në minierë» etj. Siç u vunë re nga shembujt që u sollën më sipër, po dhe nga ndonjë që ka mbetur pa përmendur, ato i përkasin disa viteve më parë, sot vepra të shquara kushtuar aktualitetit janë pak e jo më cilësinë e pritur. Le të mos mundohemi të justifikojmë dobësitë me faktin se tashmë niveli i përgjithshëm është ngritur e prandaj nuk duken majat si më parë. Arësyja që ka rënë cilësore është se ka munguar njohja e jetës, madje artistë të shquar pak ose aspak e trajtuan artistikisht këtë realitet, kurse një numër tjetër e trajtuan nën nivelin e duhur. Por, le të ndalemi më konkretisht në këto dukuri negative për të gjetur edhe rrugët e kësaj mit në një hop cilësor më të ndjeshëm, sipas orientimeve të Kongresit të 8-të të Partisë.

Së pari, duhet të nënvizojmë nevojën për një formim të shëndoshë ideoprofesional të piktorëve tanë. Eshtë ky formim ideor që i bën artistët të mbajnë një pozitë të caktuar ndaj problemeve që ngre realiteti ynë socialist. Në sajë të një pune të madhe edukuese dhe formuese që bën Partia, ky formim te piktorët ka ardhur në rritje. Artistët tanët rojnë me mësimet e Partisë, ushqehen me to dhe i ukane si udhërrëfyese në krijimtari. Shumë vepra që përmendem

më sipër janë krijuar tamam në kohën kur është përvetesar një direktivë e Partisë, kur është botuar Letra e Hapur, kur është folur për kontrollin punëtor, kur është zërthyer një direktivë për fshatin apo për elektrifikimin etj. Temat e ndryshme ideopolitike që janë zhvilluar në Lidhje, ciklet e leksioneve, diskutimet krijuar dhe problemet e ngritura në shtyp kanë ndikuar mjaft në këtë formim, po duhet të themi se ato përsëri janë të pamjaftueshme dhe e keqja është se jo të gjilanë të përfshihen në këtë punë. Ka raste që ndërthë artistët përfshihen në këtë punë. Ka raste që ndërto akoma mëngon ndonjë piktor, ka diskutime krijuar që bëhen formale, pa problematikën që i preokupon pjesë e këtyre debateve e diskutimeve nuk shkon nëpër degë te krijuarit në rrrethe. Ka ekspozita vetjake që kalojnë pa diskutime krijuarit. Kjo caktësi ideore te disa piktorë reflektohet direkt në krijimtari dhe bën që ajo të mos u përgjigjet si duhet e sa duhet atyre de-tirave që vë Partia para krijimtarisë sonë.

Më e keqja është se disa nga kolegët tanë nuk e thellojnë punën ideopolitike individualisht dhe pak punojnë përzgjerimin e horizontit kulturor, gjë që i mbani në një formim shablonesh shumë të cekta ideore dhe i-lë prapa gjithë zhvillimit që pëson shoqëria dhe arti ynë në përgjithësi. Kjo nuk është mirë të ndodhë, mbasi dihet se para artit tonë, para piktures sonë kërkesat janë gjithnjë në rritje. Formimi i lartë ideoprosfesional nuk arritet vetëm me tema e leksioneve, po me një impenjim total të artistit përtë qenë militant, përtë jetuar kohën, përtu ushqyer me kulturën e kohës dhe përtu thelluar në mënyrë të ndërgjegjshme në mësimet e Partisë. Arti dhe kultura janë, pra dhe pikatura, nuk mund të përparoja e jashtë zhvillimeve bashkë-kohore, ato janë nëndeshje me ndikimet e presionet e huaja, përballimi i të cilave kërkon formim të lartë ideoprosfesional. Ky formim të bën të aftë të afirmohesh e të afirmosh një art realist novator dhe jo një art të thatë, parrullë e skemë të rëndomtë. Pikerisht formimi i cekët ideoprosfesional e kanë burimin shumë personazhe që evenë në punë duke bërë grimaza, eipoza rgoja optimiste e patetike, shumë figura që, me gjendjen e tyre, duan të tregohen pompozë, në përmotizmin apo në dashurinë për shokun apo punën. Pas këtyre pozave e ngjyrave «optimiste» nuk

qëndron zbërthimi e kuptimi i një direktive të Partisë, por kemi një mosrealizim artistik. Te formimi i cekët ideoprosfesional e kanë burimin dhe ato tablo që pretendojnë se e dhanë temën e madhe në art, që bënë dicka nga Metalurgjia apo Komani, duke i parë figurat nga shpesh nga një figurë përgjithësuese simbolike etj. Artisti, duke mos qenë i zoti të japë përmbytjen artistike të subjektit që trajton, jep më tepër një fotografim të jetës pa transformimin artistik të saj. Ai bën pak përpjekje ose aspak përtë gjetur një strukturë të re kompozicionale, ose përtë kërkuar në elemente të tillë siç janë ngjyra, drita e vizatimi; po kështu, ai nuk i jep asnje ngarkesë emocionale figurës artistike, nuk i zërthen. Atëherë, si mund të pretendohet se e trajtuam temën e madhe në art?! Tema e madhe kërkon ngarkesë të madhe ideoprosfesionale. Kjo temë duhet zbuluar, në radhë të parë, atje ku jetojmë e punojmë. Edhe në Gramsh apo në Librazhd është kjo temë, edhe në Vlorë e në Dropull, në Ndërmarrjen e Kamzës apo në brigadat e blegtorisë e të bujqësisë, deri në familje. Paraqitja e gjithë aspekteve të jetës, e të gjitha shtresave të masave tona punonjëse, do të kompletojë atë tablo të madhe të ndërtimit socialist. Sa më tepër emë gjérë të përfshijë jetën pikture janë, aq më tepër do rritet intereseti dhe konsumi i saj. Kjo kërkon nga artisti që, në radhë të parë, të trajtojë jo thjesht temat e subjektet që mund të kenë në dukjen e parë zgjidhje efektuese, po të trajtojë një realitet që e jeton dhe e ndien thellë. Piktori i Vlorës, i Shkodrës apo i Gjirokastër, i Fierit apo i Elbasanit, duhet t'i njoftë shqetësimet e Partisë në rrëth, rezultatet ekonomike, realizimet dhe deficitet, punëtorët e brigadat pararojë etj. dhe s'ka pse të marrë «arratinë» e të lakmojë subjekte që nuk i njeh, po që i bën sepse dikush ka pasur sukses në atë temë më parë.

Militantizmi i veprës së artit është një cilësi që buron nga problematika dhe niveli artistik i saj. Ai evidentohet sa herë artisti u përgjigjet aspiratave të bashkëkohësve të vet. Kur një artist merret gjatë vazhdimisht me mullarët e barit, me dallgët e detit, me variante nusesh të festivalit, apo rrugë karakteristike në Dardhë, Berat e Gjirokastër, kur trajton tema

mitologjike, përralla kreshnikësh e shtojzovallesh, apo cikle portretesh të artisteve, ai edhe kështu sigurisht që pasqyron aspektet të jetës, madje ndër to ai dhe eksperimenton, akumulon, kërkon shprehje më të fuqishme për tema të tjera. Të gjitha këto kanë vend në krijimtarinë tonë si pjesë e jetës, po mirë do jetë që krahas tyre, ose më sakt, në vend të tyre, artisti të shohë pse vepra e tij nuk prek e nuk mishëron si duhet problemet që përballon shoqëria. Artisti i vërtetë nuk mund të kalojë pa u prekur para transformimeve socialiste, para punës titanike të njerëzve tanë që ngritën Komandin e siguruan rendimente botërore në bujqësi, nuk mund të kalojë para ndeshjeve me blokadat e vështirësitë, para bukurisë të njeriut tonë të ri. Këto duhet të zënë vendin e parë në krijimtarime nivelin e tyre ideoprofesional të lartë, madje këto emocione duhet të bëjnë që dhe temat e së kaluarës, edhe preferencat për një gjini a motive të harruara, të tingëllojnë aktuale dhe të mos ndodhë që artisti, edhe kur kap temën aktuale ta trajtojë atë nga pozita të vjetra e anakroñike, ose të transplantojë në mënyrë mekanike një frysë mitologjike groteske e ireale në subjektet e tipat bashkëkohorë. Nga etydet e bëra në Divjakë e Lapardha, në Metalurgjik apo Koman prej artisteve tanë të njohur, akoma nuk po kemi vepra që të kenë forcën e Mic Sokolit, Fushë-Kosovës, Vrana Kontit etj., s'kemi kompozime, as portrete a grup portretesh, madje ka pasur edhe ndonjë dështim, siç që rasti i tablosë së S.Kamberit, po kemi parë edhe punë të suksesshme nga krijues të rinj, si A.Miruku, Y.Haruni. Në porositë që dha shoku Ramiz Alia në Korgë nénvizozi që letërsia dhe artet të ndjekin mendimin revolucionar të Partisë, ritmet dhe rendimentet e punës së njerëzve dhe madhështinë e veprës së tyre. Në këtë proces lindin problemitë e kontradikta, jepen zgjidhje të mëdha. Pasqyrimi më i mirë i tyre do t'i japë edhe krijimtarisë forcë dhe do të rrissë indikimin e saj edukativ në popull.

Bashkëkohësit tanë duan të shohin vete në dje veprën e tyre heroike të pasqyruar artistikisht edhe në pikture. Romantikë e mundësi/pikturimi ka shumë edhe në ngjarjet e realitetit socialist e jo vetem në temat mitologjike, në temat historike e legjendat, por ajo duhet zbuluar përmes kërkimesh të rritje punë të gjatë.

Një shembull të mirë jep këtu krijimtaria e S.Shijakut në disa shfaqje të saj. Realiteti ynë duhet të jetohet e përvetësohet nga artisti në mënyrë të atillë, që të shndërrohet në një impuls krijimi. Asnjë artist nuk ka bërë veprën të fuqishme duke qëndruar jashtë realitetit. Kjo është arsyja që gati në të gjitha Komitetet e Partisë a Komitetet Ekzekutive, në Pallatet e vatrat e kulturës nuk gjen të varur në mure ndonjë etyd' a peizazh që përpinqet t'u bëjë jehonë atyre problemeve e mendimeve që zëfërë në mendjet e emocionet e njerëzve që lëvizin në ato mqedise. Ishte kënaçesi të shihje në Dajç se sa të interesuar ishin punëtorët për veprat e B.Kacelit, që punoi midis tyre, kështu dhe për A.Mirukun e N.Jonuzin në Koman e Lapardha etj. Kohët e fundit, siç dihet, janë bërë ekspozita kushtuar shpalljes së Pavarësisë, Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, disa tablo për muzetë me tema nga e kaluara. Shumë emocione e figura kanë mbetur të mjaft krijuar akoma të pashprehura dhe ndryshimet në interesat e artistit sigurisht që nuk bëhen shpejt. Kjo është e vërtetë, po kërkesa është që artisti ynë, dhe në ato raste kur trajtohen temat historike, nuk duhet të shkëputet nga emocionet dhe materiali që i jep aktualiteti socialist. Vepra si «Fushë Kosova» dhe «Mic Sokoli», «Vrana Konti» dhe «Haxhi Tahsimi» apo «Lidhja e Prizrenit» etj., nuk mund të dlinin me atë forcë ideoëmocionale në rast se artistët nuk do të jetonin fuqimisht aktualitetin socialist, me tërë forcën e dramacitetit heroik të ngjarjeve. Po këtu, kërkesa është përmirësuar që pjesëmarrje më të drejtë përdrejtë dhë përmirësuar që përfundon me të fuqishëm të piktorit nga realiteti socialist. Pjekuria ideologjike i jep mundësi piktorit që afësitet e veta profesionale e t'i vëre më mirë, në shërbim të zburnimit të idëve të Partisë. Këto idë po konkretizohen aksione që ndërmeri Partia e përgjegjësinë e rethit, ndaj të cilavet artistët nuk qëndrojnë indiferente. Si të tilla imbasë duhet të vlerësohen më mirë e t'ëmbahen, që nga organet e Partisë, sepse akoma tek-tuk raste kur ndonjë shok me përgjegjësinë nënreth nuk interesohet sa duhet e si duhet përmirësuar krijimtarinë artistike, përmes kushtet e punës, përmirësuar krijuesi, përmirësuar interesat e problematikën e veprave të artisteve jo vetë tempë hë përgjithësi, po këtë dëshpragtmë eraksioneve të

mëdha artistike. Është e vërtetë që degët e Lidhjes e trajtojnë nga afër punën e piktorëve, po konkretisht deri tani c'probleme e c'takime kanë marrë këta shokë me piktorët e c'fronte pune e porosi i kanë dhënë për ekspozitën jubilare të Partisë që e kemi në nëntor? Këtu nuk është fjala që të bëhen mbledhje të ngurta protokollare, po takime e biseda pune në studio e në shtëpi, ku artistët piktorë ta ndiejnë se për punën e tyre të frymëzuar ka nevojë Partia. Por edhe piktorët duhet ta vënë veten në pozitat e militantit, ata të angazhohen në punë e të bëjnë propozime konkrete, që nga detyrat e agitacionit figurativ e deri të panotë monumentale, afresket, tablotë qendrore, për të cilat ndiejnë nevojë masat punonjëse. Duke pranuar rolin aktiv të faktorëve subjektivë në krijimtari, theksojmë domosdoshmërinë e revolucionarizmit të tyre.

Kur shtrohet kërkesa për një nivel me në kuptim ideologjik të pikture së sonë, kjo nuk duhet të kuptohet ngushtë, që në kompozimet të mbizotërojnë thjesht vëtëm ato me temën e madhe të klasës punëtore, të fshatarësisë apo temat e lëvizjes revolucionare. Këto janë të domosdoshme, por do të thoshim se pikërisht një kuptim skematik i këtij problemi ka cuar mjaft kompozime në zgjidhje uniforme e paradoksale të këtyre témave të mëdha, ku personazhet pozojnë, ose ecinë mënyrë krenare në profil ose përballi spektatorit. Pavarësisht nga ndonjë dobësi, tabloja për naftëtarët e A. Shamit apo «Punëtorët e Komunit» e A. Mirukut, ose tabloja e S. Shifikut e M. Fushekut për punëtorët e kombinatit të Autotraktorëve, ngjallin interes te spektatorët, jo sepse thyen disa skema kompozicionale, apo se u shkëputën edhe nga një dimension rutine i figurave në raport me tablotë e këtij karakteri, po në radhë të parë, se ato dhanë me vërtetësi ngjarje konkrete, pa zbulimin. Të kuptuarit thellë ideologjikisht i realitetit do të thotë që piktori të shohë jetën e sotme dhe punën e masave punonjëse jo thjeshtësi një grumbull suksesesh, po si proces luftë e dinamike të gjallë revolucionare, ku shëmbet e vjetra dhe ndërtohet e reja me forcat tona. Një kuptim i tillë i realitetit është i drejtë dhe arrihet kur artisti e ndien nga afër këtë luftë heroike të masave punonjëse, që, të udhëhequra nga Partia, shkruanjë faqe të lavdishme heroizmi. Në përballimin me sukses të blokadës, në zhdukjen e pa-

sojave të tërmeteve, të dimrave apo thatësirave, në zhvillimin e revolucionit ideologjik e tekniko-shkencor, në kthimin e dhimbjes në forcë për humbjen e mësuesit tonë të madh, shokut Enver, e në sa e sa momente të tjera, piktura jonë duhet të mbajë një qëndrim ideoprofesional akoma më të thelli dhe akoma më novator se deri tanë. Novatorizmi i veprave që përmendëm më sipër dhei i disa veprave të tjera të mira qëndron pikërisht te kapja në mënyrë të re e dukurive të realitetit, te dhënia e tyre në një figuracion artistik më të fuqishëm. Në të kundërtën, kur artisti nuk njeh jetën e zhvillimet e saj dialektike revolucionare, forcat që veprojnë në të, dhe përpinqet të trajtojë temat e ditës me një bagazh të vjetëruar ideoprofesional, ai pa tjetër do të bjerë në zgjidhje të njoitura dhe në emociione të provuara më parë, që përpinqet t'i rinojgojë duke bërë arnime të vogla me ndonjë vendosje gjoja «interesante» të ndonjë figure e me ndonjë velaturë koloristike «të paparë». Si konkluzion, mund të themi se përgatitja më e thiellë ideologjike e piktorëve tanë, mbushja e krijimtarisë me idetë e mëdha të jetës, të parit e jetës me mësimet e Partisë e të shokut Enver, janë kushte të domosdoshme, pa të cilat nuk mund të realizohet hopi cilësor i pikturës sotë.

Së dyti, duhet të térheqim edhe një herë vëmen-djen pér një njojje më të thellë të jetës. Për këtë çështje Partia ka dhënë gjithënë porosi, sepse është jetë e gjallë ajo që e mban dhë e zhvillon artin. Lidhja me jetën është një koncept ideologjik, është lidhja me interesat e kërkuesat e shoqërisë, është njojja dhe dhënia përgjigje problemeve aktuale të kohës. Largimi nga jeta është largimi nga pozitat e realizmit socialist. Veprat me nivel mesatar kanë në vetvete një njojje të cekët të jetës dhe, si pasojë, dhë një shkallë emocionale të reduktuar. Në dukje ato krijojnë njëfare komoditeti, por më vonë ky komoditet të shtyn në përtaci artistike, të skematizon, të fut në frymën e artit mikroborgjez, që nuk do t'i hapë telashë vetes, të bën epigon duke përsëritur gamat e preferuara a një mënyrë të njojur konceptimi artistik. Është fakt së vepra të nivelit mesatar pranohen ende në ekspozita; ato qëndrojnë në sfond dhe kritika merret pak më to, duke u përqendruar, më shpesh, në veprat më të mira. Diskutimi pér burimin e nivelit mesatar më veprat

pikturës duhet të bëhet më i thellë, më i argumentuar dhe jo më doreza. Të metat e mangësitë, duhen thënë troq e më kurajë, sepse duke mbajtur me hatër një vepër të dobët apo një ekspozitë të dobët, siç që ajo te Tlotës, apo e ndonjë krijuesi të ri, i bëjmë dém një çështjeje të madhe: forcimit të artit tonë të realizmit socialist, ecjes e zhvillimit të drejtë të talenteve të reja. Ka qenë shumë dobiprurëse pjesëmarrja e artistëve në aksionet që kanë organizuar rrëthet e ndryshme dhe vajtjet në bazë me afate të caktuara. Ato kanë shërbyer si përvojë me vlerë, ku kanë mësuar një numër i madh artistësh. Megjithëse momentet e mënyrat e njohjes të jetës janë të ndryshme (dikush bën skica, dikush etyde, dikush punon kompozime, dikush nuk punon fare po vetëm vëren), prapë duam të theksojmë, se flasin për njohje të cekët rastet kur ndonjë artist «futet» nëpër revistat e fotografi dhe largohet nga emocionet e natyrës. Një tërheqje e tillë nga kontakti me jetën nuk ndodh menjëherë dhe nuk është e lidhur as me moshën, as me mungesën e komoditetit të punës. Kjo tërheqje vjen gradualisht me zbehjen e kërkeseve ideoestetike të artistit ndaj vetes dhe kënaqjen e tij me faktin që puna ekspozohet apo shitet. Hera-herës ndodh që për një arësy apo tjetër, të ketë sukses dhe ndonjë vepër, autori i së cilës nuk ka qëndruar aq gjatë në atë kantier pune apo kooperativë së cilës i kushton veprën. Të tillë momente nuk mund të shërbejnë si shembull sidomos përkrijuesit e rinj. Suksesi i veprës dhe njohja e jetës nuk maten me ditët e punës dhe kohën e shërbimit. Ato janë cilësi që burojnë nga bota emocionale e artistit, nga përgatitja e tij, nga mënyra si e shiken dhe interpretoton ai jetën në të gjitha shfaqjet e veta goftë dhe në një fotografi apo dokumentar filmi, sepse është fakt që ne kemi raste të artistëve që kanë qenë në bazë, dhe pas kësaj kanë bërë një vepër që i ngjan fotografisë jo artistike, ashtu siç kemi dhe raste kur nga një fotografi artisti bën një interpretim të thellë të natyrës. Puna është që pikturen mos ta bëjmë fotografi, dhei fotografinë ta shohim me syrin e piktorit.

Tërheqja nga kontakti me jetën të ndonjën piktor ndodh edhe simezultat në vetebesimi të tëpëruar, kur atij i diskretitës e ndiqte mjetin e kartës së q'do të

bëjë, ose nga ndjenja e inferioritetit e paafëtësë profesionalë përballë natyrës, kur ai ka frikë se s'do ta vizatojë dot tamam, s'do ta bëjë shpejt e mirë etj. Nga të dy këto raste nuk vuajnë kategori të caktuara piktorësh, po ndonjë që mendon se me dy-tri takime më realitetin e grumbulloj materialin, me dy-tri skica dhe një sërë fotografish ai mund të krijojë tablora e portrete të ndryshme. Dhe të tillë janë krijuar, po në ndonjë rast duken si të nxjerra nga konvejeri, pa pulsin dhe emocionin që të krijon vepra e brumosur me mendime e variante të ndryshme. Ky arsenal mjetesh artistike, i përdorur me sukses në një vepër, nuk duhet t'i japë atij shkas që dhe në të ardhmen të vërtitet në të njëjtat gjëra. Jeta është e gjallë, me zhvillime revolucionare dhe s'ka pse të rrимë duke parë duke shfletuar e rrotulluar nëpër duar skica dhe etyde që kemi bërë vite më parë, pa nxjerrë prej tyre ndonjë dobi të madhe. Emocionet që të jep realiteti janë krejt të tje- ra dhe ne e vëmë re menjëherë këtë kur shohim një kolegut tonë, qoftë dhe artist të ri, që sjell diçka të re e të frëskët nga jeta. Në një situatë të tillë duhet hedhur poshtë ngurimi e frika dhe duhet shkuar përsëri e përsëri në bazë, në jetë, për të mësuar e përtu freskuar. Të tjerë, të përgatitur dobët në shkolla, të mjaftuar me ato njoburi që kanë marré dikur, nuk i sheh më të bëjnë një etyd nga natyra, një skicë, një variant portreti a tipi për kompozime dhe janë gjithnjë e më të ndrojtur para veprës së tyre, duke pyetur e ripyetur kolegët e komisionet, duke bërë e ribërë çdo gjë që i thonë vizitorët e parë në studio. Në qoftë se kemi një rezultat të mirë në punën e mjaft peizazhistëve, kjo ndodh dhe përfaktin se shumë nga ata e kanë mbushur veprën e tyre me emociione të marra drejt e nga natyra. Ata e kanë zhdukur ndrojtjen para natyrës dhe japidin një shembull të lidhjes së artit me jetën. Ky është një avantazh që e ka gjinia, po ka patur dhe raste që disa peizazhe përkemi kritikuar se ishin punuar në studio apo nga fotografia. Pse këtë avantazh nuk e ka portreti? Sigu- risht që e ka, por është një e vërtetë jo e mirë, por që duhet pranuar se në materialin përgatitor të portretistëve atyre që krijojnë tablo kompozicionale gjë pak ose aspak material studimi. Këtu nuk është fjalë për detyrat shkollareske, se jemi larg kërkuesave e per-

qendrime të ngurta e fotografike nga jeta, siç jemi larg dhe kërkesave për abstragime formale. Nënvilajmë këto momente se është pikërisht njohja e cekët e jetës ajo që ka krijuar në pikturën tonë njëfarë zbehjeje të pulsit e forcës së saj ekspressive. Ka shumë veprat me pak gjetje kompozicionale e koloristike, sepse ndër to ka pak material jetësor. Suksesi i «Tornitorës» së Zef Shoshit, i «Punëtorit» të A.Bashës, i «Sharrëxhiut» të A.Lushit i «Nuses» së S.Shijakut, i «Mjelëses» së S.Capos i «Naftëtarit» të V.Kilicës etj. Është ngritur mbi njohjen dhe dashurinë ndaj njeriut të punës. Këtë forcë realiste e karakteresh gjiejmë dhe te portreti i studentit i J.Kerajt, edhe te figurat e punëtorëve, megjithëse të vogla, në kompozimet e D.Jukniut, I.Lulanit, A.Kostandinit. Duke u ndalur në mënyrë të veçantë në përpunimin e materialit jetësor, theksojmë se ai duhet të vijë nga jeta i grumbulluar jo si një masë amorfë, jo si një numër i madh skicash e etydesh, jo si diçka e shpejtë. Ai, duke ardhur në studio si material i gjërë jetësor, duhet, njëkohësisht, të grumbullohet në jetë në shumëllojshmérinë e në paraqitjen e tij shumëplanëshe. Nuk është e vërtetë që të gjithë punëtorët dalin nga miniera duke buzë-qeshur, nuk është e vërtetë që metalurgët tanë lexojnë gazetën mu përparrë furrës së shkrirjes etj. Këto ndodhura herë që piktori vete atje i ngarkuar me skema të hartuara që më parë në kokën e vet dhe pastaj çdo gjë që shëh e fut në këto kallëpe të parapërgatitura, duke krijuar kështu vepra skematike që pasqyrojnë jetën e një plan gjoja optimist. Punëtori ynë del dhe i loddhur nga puna, metalurgu dhe minatorët e naftëtarët kanë edhe mosrealizimë. Këto i themi jo që tani në pikturen tonë të dalin punëtorët që nuk kanë realizuar planet e që vijnë të rraskapitur nga lodiha jo por i themi që artisti këto fenomene ti ndiejë në jetë, ta ndiejë që atje luftohet me vështirësitet, pra materiali që ai do të grumbullojë të mos jetë i një plani vëtëm me ngjyrat e velura, vëtëm me poza krenare, vëtëm me entuziazmin e duarve lart etj. etj. Vetëm mbi një material të vërtetë jetësor e jo të stisur mund të kriohen veprat të fortë të realizmit socialist. Mbi një material të tillë artisti pastaj e ka më të kollajtë që të mendojë, të përgjithësojë estë abstragojë për vepren se ardhshme. Nga ana tjetër, ky material shumë-

planësh i vlen artistit edhe për vepra të tjera në të ardhmen, kur ai mund të trajtojë herë tema dramatike, heroike apo intime etj. Mbi këtë bazë ecën dhe rrinovimi i mjeteve shprehëse, të ngjyrës e të kompozimit; ato asnjëherë nuk mund të zgjidhen me sukses jashtë përpunimit të asaj që është vjelur ngajeta. Që mbas plenumit të 4-të, të KQ të PPSH më 1974, ne kritikuam me forcë ato qëndrime formaliste në pikturnën tonë që ishte rezultat i largimit prej jetës dhe që ushqenin largimin ngajeta. Ishte kjo një luftë që e shëndoshi artin tonë në përgjithësi dhe pikturnën në mënyrë të veçantë. Po në qdo takim e diskutim, në krijimtarinë tonë, gjithnjë ne kemi theksuar me të drejtë luftën që duhet të bëjmë në mënyrë të vazdueshme kundër formalizmit e skematizmit, sepse ato nuk zhduken me një goditje, por mund të shfaqen e rishfaqen në forma të reja.

E theksojmë këtë moment dhe përfaktin se në aritet tona vijnë qëdo vit breza të rinj artistësh, sigurisht me një formim më të shëndoshë ideoprofesional, po që dhe atyre, në kushtet e reja të zhvillimit tonë dhe të luftës më influencat e presionet e artit dekadent borgjez e revizionist, do t'ju takojë që të ndeshen me dukuritë formaliste dekadente. Ata duhet të jenë të përgatitur për këto ndeshje dhe të mos bien pre e lajthitjeve formaliste skematike apo natyraliste. Është deptyrë e artistave më me përvojë, që i kanë kaluar me sukses këto ndeshje, që kanë një formim të mirë ideoprofesional, ta mbajnë pranë dhe ta orientojnë drejt krijuesin e ri, ta mësojnë atë me dashurinë përfundën, me luftën kundër rehatisë e pretendimeve, me shpirtin e sakrificës, t'i edukojnë atij dashurinë përfundjen, për artin e madh popullor për traditën e re të realizmit socialist, që edhe ata të krenohen me veprën e paraardhësve e, duke mësuar nga ajo, ta cojnë artin tonë më përparrë. Nga ana tjeter me qëndrimin e shembullin e vet, artistët me përvojë duhet t'u edukojnë talenteve të reja shpirtin novator e kërkues, karakterin luftarak, kundër çdo lloj rutine skeme e formalizmi, kundër ndjenjës së të kënaqurit me pak, por dhe kundër lajkave apo mëritë mikroborgjeze.

Po i dukuritë formaliste, skematike apo natyraliste nuk mund të shfaqen vetëm te krijuesit e rinj, por përvojë. Eksperiencia ka treguar se ato mund të mole-

psim dhe një krijues me përvojë sa herë që ky humbet stabanin e shëndoshë ideologjik në krijuartari. Prandaj, lufta për novatorizmin e artit tonë, lufta kundër artit dekadent borgjez e revisionist, si dhe kundër dukurive të huaja në artin tonë, duhet të bëhet në gjithë frontet, si në letërsi dhe në artet figurative, si në muzikë dhe në teatër etj. nga të gjithë artistët, me të njëjtin qëndrim, të mbështetur mbi mësimet e Partisë dhe veprën drithdhënëse të shokut Enver.

Aktualist piktura jonë, si gjithë artet e tjera, lufton që në të tjetër futet më fuqishëm realiteti socialist. Përpjekjet e artisteve tanë janë të lavdërueshme në këtë drejtim. Mund të kemi vrejtje për tablonë «Gjumë gju me popullin», për mozaikun te Muzeu Kom-bëtar, për «Minatorët e Pishkashit» e për tablo të tjera, por artistët që janë marrë me këtë tema janë vënë para detyrash të rëndësishme. Jeta socialiste futet fuqishëm në art përmes temës së madhe. Prandaj ne na takon të luftojmë akoma qëndrimet e cekëta ndaj fenomeneve të jetës, sepse ka tablo që vërtet trajtojnë temën e ditës, madje dhe ndonjë temë të madhe, po janë në mes të rrugës. Ato nuk i kritikon dot se kanë dukuri formaliste në ngjyrë apo në vizatim, nuk i kritikon dot se përdorin ngjyrën të shkëputur nga materialja e nga atmosfera reale, qdo gjë në një tablo të tillë është në vendin e vet, palat e rrabave, duart e këmbët e vizatuara, po në to mungon emocioni, shpirimi krijues e novator dhe një pjesë e tyre duket sikur e ke parë në ekspozitat e miëparshme. Vepra të tillë vërtet nuk e kanë formalizmin në mjetet shprehëse, po ato e kanë atë në kapjen sa për formë të temës së madhe. Nuk duhet vetëm të sjellim punitore e fshatarë në ekspozita që sa të emërohen si të tillë, po duhet të luftojmë që ata të jenë të piktuar bukur e me forcë. Eshtë kjo arsyesa që pëlqehet «Portreti i shokut Enver Hoxha» i M. Fushekaitit, «Kooperativistja» e S. Shijakut, «Barinjtë» e D. Juknuit. Veprën e artut e mban përbajtja, po dhe forma që e lartëson këtë përbajtje dhe mjeshteria artistike me të cilën e trupëzojmë. Në si tanë i kemi në kujtesë porositë e shokut Enver në vizitën që ai i bëri në Galerinë e Arteve në Tiranë. Duke falenderuar artistët për ato krijime të bukura, i shoku Enver porositi që të thellohem i më tepër në mësimet e Partisë dhe të lidhen me jetën, për

t'i dhënë veprave më tëpër përbajtje, po theksoi ai, dhe mjeshterinë e zanatin duhet t'i perfektionojmë më tepër.

Në artin tonë ne kemi mjaf shembuj, kur bashkë me temën e përbajtjen e fuqishme kemi dhe një formë të lartë artistikë. Me kërkesat në rritje që ka arti ynë sot u duhet hequr e drejtë për të hyrë në ekspozita, veprave me mangësi ideoartistike e që nuk i kanë të lidhura organikisht formën me përbajtjen. Tema e klasës punëtore, tema e ditës nuk është një plakat thirrës apo një nocion anekdotik, që miratohet brenda shtjellimit e konkretizimit realist fotografik. Ajo quhet e zbërthyer kur në të elementet e formës artistike tingëllojnë në luftë me kërkesat natyraliste të përqeshjes së natyrës, po dhe në luftë me dukuritë formaliste. Tani shumicën e piktorëve tanë nuk mund t'i kritikosh se nuk trajtojnë temën e ditës, ata mundohen me seriozitet të gjunjë subjekte e ndodhi nga shumë aspekte të realitetit socialist, po kjo nuk mjaf-ton pa elementet shprehës e të formës artistike që duhet të zbërthejnë këtë përbajtje. Dhe duhet thënë se, duke u nisur nga përbajtja e rëndësishme e veprave tonia, më me seriozitet duhet punuar në drejtim të mjeteve me të cilat e trupëzojmë këtë përbajtje në mënyrë emocionale. Më tepër duhet menduar për ndërtimet kompozicionale, përfocën shprehëse të ngjyrës dhe vizatimit, për harmoninë e kontrastet, për prerjet, grupimet etj. Me përbajtjen e re nuk vjen vetë forma artistike. Kjo sigurisht që ndikohet, por përcaktues është dhe subjekti, d.m.th. vetë artisti, sa preket nga kjo përbajtje. Ky prekupim i vërtetë lind tek artisti i ndërgjegjshëm e militant, i cili aftësinë e tij profesionale nuk e mat me «hedhjen e guximshme» të penelave, po me afirmimin e idealeve të vërteta estetike të brumësura me ideologjinë marksiste-leniniste. Kërkimi i mjeteve shprehëse të reja, që të trupëzojnë artistikisht përbajtjen e re e të fuqishme që na jep jetë, nuk mund ta bëjmë në mënyrë të shkëputur nga realiteti. Që të rrisim forcën shprehëse të ngjyrës s'ka pse të injorojmë materien dhe atmosferën në tablo, që të rrisim dekorativitetin e saj s'ka pse të lyejmë në mënyrë të ftohtë si përfaqës të tjerë në pikture e të bëjmë p.sh. kominoeshet e punëtoreve njësoj, si në një tablo kte tjetra! Duke

përpunuar mijetë të reja shprehëse, struktura të reja kompozicionale, lineare a koloristike, ne do të biem ndesh dhe do të hedhim poshtë një strukturë të vjetër kompozicionale a koloristike, e cila nuk mund ta shprehë përbajtjen e re. Ky proces do të bëhet me luftë, sepse përvite të tëra ne jemi ambientuar me një mënyrë konceptimi dhe veprat novatore sot nuk mund të gjykojnë të nisur nga konceptimet e vjetëruara, pra dhe gjykit e kritikës e të komisioneve duhet të bëhen nga pozita të kërkuesave novatore që mbështeten mbi partishmérinë e mbi shijen e artit të madh të popullit. Në diskutimet tonë krijuese ne kemi kritikuar me të drejtë edhe ndonjë trajtim ekspressionist, impresionist apo manierist, po tabani i krijimtarisë së atyre artistëve ka qenë dhe mbetet i shëndoshë e s'ka pse të mendohet se krijuesit iu vu nofka e piktorit impresionist apo ekspressionist. Ndërkohë artisti duhet të bëjë përpjekje për të shprehës së «nuk kuptohet». Kërkimet dhen bërë në rrugë të -drejtë. Metoda e realizmit socialist e ka në parim kërkuesën përvitje novatorizmin dhe realiteti ynë socialist nuk të shtyn në trajtime të izmavë të huaja ku i shtyn realiteti artistët në vendet borgjeze e revolucioniste. Një artist i ymi mund të bjerë në trajtime izmash të huaja (sic ndodhi para Plenumit të 4-t) jo i shtyrë nga temat që trajton, po i shtyrë nga formimi i dobët ideologjik e profesional, sepse një huazim ekspressionist ku eliminohet materja, figura njerëzore e hidhet ngjyra në tablo si me hedhë baltë, nuk është as novatorizëm e as injet për të shprehur realitetin socialist, kështu ndodh dhe me trajtimet impresioniste e formaliste apo manieriste.

Kerkimi i së resë në përbajtje e formë është një nga detyrat e rëndësishme dhe të Kongresit të 3-të të Lidhjes! Në të gjitha fushat e jetës e të prodhimit tani kërkonet e reja, më e përparruara. Zhvillimi i shijeve e rritura e kërkesave, i bën po ashtu të domosdoshme këto kërkime siç i bën të domosdoshme dhe numri i shumteri veprave që pa novatorizmin e tyre e me niveli mesatar, mund të krijojnë monotonji. Kur arrihet kështet zhvillimi më art, u theksua në Kongresin e 3-të të Lidhjes, duhet menduar përkapërcimine e tij, pernaryshe lind përshtatja me mesataren që është në

fakt regres pasi frenon zhvillimin. Piktura jone realizmit socialist po përballon detyra të ndryshme në të gjitha zhanret dhe gjinitë e saj, duke luftuar për një zhvillim harmonik të tyre. Kërkesa pér t'u shkëputur nga niveli mesatar tanë duhet të realizohet përmes një puqe më të madhe. Do të ketë edhe veprat e dobëta, diletante apo mesatare, po ne duhet të bëjmë kritikën e tyre, të analizojmë burimet e tyre. Do të ketë dhe ekspozita të nivelit mesatar dhe për ato duhet të diskutojmë. Në diskutimin krijues pér ekspozitën e Flotës, disa krijues ngurruan ta quamin atë ekspozitë mesatare e të dobët dhe bënë presion që galeria të blinte më tepër punë. Ndonjë ekspozitë vetjake të parakohëshme e të dobët mund dhe mos ta hapim. Artisti do të ketë fitim në këtë rast por dhe shijet e kërkeshat e publikut nuk i çorodisim. Tendencë e përgjithshme të artit tonë e japin veprat e mira, po pranë tyre bashkëjeton dhe një krijintari mesatare bëhen dhe vepra të dobëta që, në ndonjë rast, nga njerëz e artistë të paformuar fryhen pér vlerat e tyre. Luftën duhet ta bëjmë që të shtojmë veprat e mira duke ngritur nivelin mesatar, kurse veprat e dobëta mos t'i lejojmë që të mbrohen pas mängësive të veprave mesatare. Lufta pér të sjellë në pikturen tonë një qëndrim më novator në përbajtjen dhe në formë, është e lidhur me kërkeshën e drejtë që parashtron tanë spektatori ynë ndaj artit në përgjithësi. Ajo tanë shtrohet dhe në kuadrin e pasqyrimit më me vërtetësi të jetës. Kjo luftë do të fitohet nga krijuesit më të partishëm, më të formuar nga ana ideoprosfessionale, përmes një puqe të gjatë e të frymëzuar me dashurinë për artin tonë, për të bukurën, për Partinë.

Një roltë rëndësishëm në ecurinë e pikturesh sonë ka dhe mendimi kritik që shprehet në shtypin tonë, si dhe në diskutimet krijuuese. Me gjithë ecurinë që kemi shënuar duhet të pranojmë se në artikujt tanë dhe në debate deri tanit nuk kemi ecur më tepër vetëm duke afirmuar disajvepratë mira. Në ndonjë rast ky afirmim duhet të bëhet më i thelle dhe të ngjallë frymëzim e jo vetëm të citohet. Por krahës kësaj kritika jonë dhe diskutimet krijuuese duhet të evidentojnë më mirë ato probleme që përbëjnë thelbën e krijimtarisë mesatare. Sepse në ndonjë rast, duke qenë ja stëpë kritikës së fortë që do t'ju

jimtar, ka zënë ngandonjëherë pozitë të stabilizuar në ekspozita dhe ka shërbyér gabimisht si mbështetje ku janë mbrojtur veprat e dobëta. Kjo ka ndodhur sepse është ngurruar të kritikohen konkretisht artistët, qofshin këta dhe me emër, për ndonjë vepër të nivelit mesatar. Edhe artistët më të shquar kanë ndonjë krijim të dobët, apo mesatar. Pse nuk duhet ta përligjim atë dhe për të kritikuar me rremi më tepër me ndonjë fillestar, ose me ndonjë vepër që është shumë e dobët vërtet? Fryma shoqërore, preokupimi i lartë etikomoral për mbarëvajtjen e artit tonë të realizmit socialist, duhet të na orientojë drejt një kritike të shëndoshë, jo vetëm pa sharje, mëri, hakmarrje e denigrim, por edhe pa mburrje, elozhe e thurje lavdishë, për ta patur mirë me dikë ose për t'u dukur baba-xhan.

Po kështu, vëmendje më të madhe kërkon edhe krijimtaria e paekspozuar e cila, në ndonjë diskutim krijues, ka kaluar vetëm me një paragraf, pa analiza të thella ideoprofesionale. Sigurisht, një krijues i mirë e gjen vetë rrugën në të cilën do të ecë, por ka mjaft që duan të ecin në shqipje të pashkelura, që kanë aspirata të vërteta artistike, që kanë aftësi dhe mundësi që këto aspirata t'i kristalizojnë me vepra madhore. Ndaj tyre mendimi ynë kritik duhet të mbajë një pozitë më të pjekur e më orientuese. Mund të bëhen dhe artikuj kritikë për artistë të vëçantë; për rrugën e tyre krijuese, tendencat, problemet. Kritika jo-në mund të orientojë më mirë luftën kundër ndonjë dukurie negative të një grup vepresh dhe mund të stimulojë më tepër krijimtarinë e artistëve të rinj, po jo duke i përkëndhelur e duke u bërë reklama të pamirituara. Këtu nuk është fjala që në artikujt e diskutimet tonë të nxjerrrim nga ndonjë shembull të mirë, por të zbulojmë e të orientojmë drejt interesat krijuese të artistëve, nga të cilët të mësojnë dhe kolegët e tjëre. Duke synuar një zhvillim më të shëndoshë të mendimit tonë kritik, e quajmë të domosdoshme të theksojmë luftën që duhet të bëjmë kundër indiferençimit, dher kundër subjektivizmit, mikroborgjez. Nuk është mire që nga shumë krijues me përvojë nuk gjemë gjekundi, ose shumë-shumë rrallë, një mendim kritik për një ekspozitë, për një vepër të vëçantë, apo për ndonjë talent të ri, që persakohet, në radhët

tōna, ndérkohë që ata diskutojnë për këto probleme jashtë mbledhjeve. Dihet se sa i rëndësishëm e sasi argumentuar do të tingëllonte mendimi kritik në fjalën e vetë krijuarve.

Format për ta vjelur këtë mendim duhet t'i gjejë më mirë edhe shtypinynë i Lidhjes, ashtu si dhe vetë ky shtyp duhet të nxisë më tepër rrahjen e mendimeve të kundërtta në faqet e gazetave, pa botuar artikuj tendenciozë që bien në kundërshtim ose e përshin frymën e shëndoshë midis artisteve tanë.

Mendimi ynë kritik, krahas evidentimit e paraqitjes të artistëve e veprave, të ndalet më mirë në ato punë që kanë interes për t'u diskutuar, që ngrenë probleme të karakterit profesional dhe që kërkojnë zgjidhje përmes debatit.

Hapjen e një ekspozite, paraqitjen ose jo të një vepre në ekspozitë dhë têrheqjen e tyre nga galeritë e kanë në dorë komisionet e ngritura nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve apo Komitetet Ekzekutive në rrethe. Përgjegjësia këtu është e mëdha, po shpesh me gjithë prëokupimin që kanë patur këto komisione, ka patur raste të gjykimeve subjektiviste, ka patur dhe lëshime nga pozita sentimentale. — Në punën e komisioneve duhet të shtohet kontrolli, të mënjanohen paralelizmat, shpesh të rigjenerohen me anëtarë të rinx, të rritet përgjegjësia e të mënjanohen diskutimet e cekta e të paargumentuara. Çdo gjë, në bazë dhe në qendër, t'ia nënshtrojme një diskutimi më të partishëm, duke mos marre parasysh prekjen e interesave të vogla mikroborgjezë e të sedres së sëmurë, po duke u shqetësuar për atë ushqim të shëndoshë shpirtëror që do t'u japid masave tona punonjëse. Përballë lëvrimit të të gjitha gjinive në mënyrë të harmonishme, ne duhet të jemi më kërkues. Shumë mirë që lëvrohet gjerësish përzazhi, po pse piktorë të afirmuar nuk angazhohen për të bërë vepra që kërkohen (jo vetëm mozaikë e afreske) nga institucionet e rretheve ku ata jetojnë? Pse disa piktorë kanë hëqur dorë nga puna me portretin e grup-pörtretin, me temë nga aktualiteti? Dhe, sé fundi, qështë kjo dyndje kërkesash për të bérë ekspozita vjetjakeri jo gjithnjë me nivelin që kërkohet?! (Një farë ekspozitë manie?) Ose, pse vepra të pëakspozuar, përvërejtje të rendësishme në qendër, blihen nga muzezët e galerive

e tretiveve? Shumë prej këtyre pyetjeve mund t'u jepte përgjigje, dhe një punë më e mirë e komisionit të pikturës pranë Lidhjes, por mund të diskutohen edhe më konkretisht këtu.

I nënvisojmë këto momente edhe si hallka të një problemi të rëndësishëm, siç është ai i demokratizimit të mëtejshëm, të pikturës sonë, i lidhjes së saj më të mirë më jetën e njerëzve tanë. Nga krijuesit bëhen vepra me porosi nga shteti, realizohen porosi për muze e galeri të artit, realizohen dhe porosi private, si dhe vepra për t'u shitur në dyqanin-sallon. Shkalla e vlerësimit prej artisti e gjithë këtyre porosive është e ndryshme. Si pasojë, veprat që janë të destinuara të hyjnë në shtëpitë tonë si vlera materiale e shpirtërore e me të cilat njeriu ynë do të krijojë lidhje intime, nuk janë gjithnjë të nivelit që kërkohen. Një pjesë e mirë e tyre më tepër shpërndahen në institucione, sesa kërkohen nga spektatori. Ulja e kërkave ka krijuar ndjenjën e kollajllékut për të bërë, për të eksposuar e për të shitur «piktura». Kjo lloj krijimtarie nuk lë pa ndikuar dhe veprat që destinohen për eksposita kombëtare, duke futur dhe tek ato kërkesa të ulëta e nivel mesatar, në vend që të ndodhë e kundërtë.

Dësheronim të ngrinim dhe një problem që ka dhjhe me atmosferën e punës në të cilin mund të luajnë një rol më të rëndësishëm talentet e reja, që po hyjnë në pikturën tonë si një detashment i fuqishëm e i përgatitur, për t'u dalë në krye detyrave të reja që shtron zhvillimi i artit tonë. Këtë mision të krijuesve të rinj, në e nënvisoam dhe në Konferencën Kombëtare në Durrës. Te të gjithë ne, e veganërisht te krijuesit e rinj, duhet të forcojmë edukatën e punës të punohet më tepër, të lodhem më tepër, vazhdimisht e jo, në prag të aktiviteteve apo vetëm në muajt e lejes krijuese; ti bëjmë studiot e shtëpitë tonë galeri të vogla, e të mos na hanë muret bosh me varférinë e tyre.

Duke hyrë në vitin jubilar të 45-vjetorit të Partisë në vitin e Kongresit të saj të 9-të, të gjithë krijuesit mendojnë për veprat e tyre, dhe për vendin që do të zëne me to, ndjenjat e mendimet e bashkëkohësve tanë. Është kynë një aksion shumë i rëndësishëm e me shumë përgjegjësi. Piktoret tanë, si gjithë artistët e tjera do të vilen në ballë të punës. Se afundi, shpallja e çmimave për veprat më të

mira vjetore është një nxitje e re për artistët tanë, ata do punojnë sepse kanë një përvojë pune e lufte të pasur, kanë një krijimtari të shëndetshme, kanë një jetë frymëzuese të popullit tonë dhe kanë një kohësht porositë shumë të vyera që na dha shoku Ramiz Alia. Veprat që ata do krijojnë do ta cojnë më përpara artin tonë të realizmit socialist, do ta ngrenë më lart lavdinë e popullit e të Partisë, duke vënë në jetë porositë e të paharuarit, shokut Enver Hoxha.

SHOQËRUA PËR VETËVENDOSJE

SHALLOJA E SITIT E KOMITATOIT

Nga diskutimet

ANDON KUQALI

MË SHUMË KËRKESA CILËSORE NË TRAJTIMIN E TEMËS AKTUALE

Eshtë e vërtetë se edhe në fushën e arteve figurative dhe të pikturës së këtyre tri-katër viteve të fundit, vihet re përgjithësisht një nivelim artistik, një ambientim me mediokritetin. Kjo duket në disa ekspozita kombëtare dhe personale të kësaj periudhe.

Tema, aktuale eshtë trajtuar gjérësisht në pikturën tonë, por nuk janë aq të shumta veprat të cilat kanë pasqyruar me art këtë realitet. Ka shumë kompozime që janë thjesht përshkruese, portrete që prekupohen të na jepin vetëm ngjashmërinë e personit, peizazhe si panorama të thjeshta.

Forca sugjmissive, e tablove të tipit «Barinjtë në bjeshkë» e D. Juknuit, «Zëri i masës» e S. Shijakut, «Buka e duarve tona» e S. Kamberit, «Portreti i shkurt Enver Hoxha» i V. Kilicës, «Mjelësja» e S. Capos, peizazhi «Dallga» e N. Jonuzit etj. qëndrojnë në faktin se ato duke krijuar figure artistike, kanë bërë përgjithësim artistik historiko-filozofik.

Nëntori

32

Karakterin fotografik pëshkrues e sjell edhe kërkesa nga ana e disa përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme, e muzeve etj., për një pikture thjesht ilustruese, si dhe konformizmi i komisioneve dhe zhurivë të ndryshme të ekspositave, konkurseve etj. Gjithashtu, në riprodhime dhe në shtyp, botohen e popullarizohen tablo e vizatime vetëm duke u nisur nga tema apo subjekti i tyre, kur këto tablo e vizatime nuk kanë asnje vlerë artistike. Nga ana tjetër, ka mjaft raste kur vepra e bukur, realiste, por që ka dalë jashtë rutinës, ku është shfaqur fantazi dhe një shprehje më ekspressive, nuk është pranuar në ekspozitë. Ky qëndrim konformist bën që të inkurajohet një pikturë pëshkruese fotografike, të inkurajohet mediokriteti. Piktura nuk ka vlerë artistike, nuk ka forcë emocionuese, në qoftë se ajo mbetet te faktet e përditshme. Kemi krijime të pikturës sonë, si «Ujita» të A. Fajës, «Mitingu për denoncimin e traktatit të Varshavës» e V. Kilicës, ku ngjarja e ditës është ngritur në një përgjithësim historiko-filosofik, në të shfaqet forca, karakteri, tradita luftaraKE e popullit shqiptar. Duhet që faktit real, ngjarjes, figurës së njeriut, mjedisit, t'i bëhet një interpretim artistik. Leonardo da Vinci ka thënë se objekti i pikturës është njeriu me përfjetimet e tij, mendim, i cili ka vlerë për gjithë letërsinë e artet. Kjo do me thënë se në pasqyrimin e ngjarjes, të zbulohet njeriu, bota e tij shpirtërore dhe që në pasqyrimin e realitetit të jepet qëndrimi ideoemocional i njeriut ndaj këtij realiteti. Në qoftë se në pikturën tonë, do të pasqyrojmë një ngjarje, qoftë nga jeta e përditshme, apo një pamje të mjediseve tona të transformuara, në to duhet të zbulohen, të shprehen mendimet emocionale, ndjenjat që i ngjall njeriut tonë të socializmit ky realitet.

Një pasqyrim i tillë kërkon një shprehje të bukur artistike. Prej këndej del problemi i ngritjes cilësore të pikturës sonë. Një shembull të mirë të një interpretimi të tillë kemi te pikturat e S. Shijakut, skenat nga puna e përditshme në arat e kooperativës, portretet e tij të nuseve, peizazhet e Tiranës. Drita e kthjellët, vizatimi ekspresiv, ngjyrat e gëzuara pasqyrojnë në këto vepra shqetësimin, gjëzinin, optimizmin e njeriut tonë të shoqërisë socialiste.

33

3/1986

3 — Nëntori III

Lartësimi artistik i realitetit tonë, kapërcimi i nivelit mediokër kërkon edhe zhvillimin e mjeteve shprehëse të pikturës sonë realiste, kompozime dinamike, vizatim ekspresiv, pikturë me ngarkesë emocionale, që t'u përgjigjet gjallërisë, dramacitetit, shqetësimeve, luftës revolucionare të shoqërisë së kohës sonë.

KRISTAQ RAMA

FORMA E BUKUR USHQEN DHE RRIT PËRMBAJTJEN

Aktualiteti në art ka një karakter të gjerë e të shumanshëm. Ai nuk qëndron në sipërfaqe, të pozojë indiferent para objektivit të fotografit, dhe nuk ezaurohet me një regjistrim të thjeshtë të fakteve e ngjärjeve, por kërkon zberthim dhe analizë të thellë ideoestetike, kërkon mishërim adekuat me formën e lartë artistike. Në rastin tonë, kërkon gjuhën e përshtatshme figurative që ka mjetet e saj shprehëse, shumë të larmishme e të fuqishme. Por e keqja është se jo rrallë në veprat e arteve figurative predominojn naracioni, gjestikulimi i jashtëm, shpjegimi detrareshk pa emocion të vërtetë kompozisional, plastik e koloristik. Ngakjo vuajnjë disa vepra pikture që tentojnë të ngrenë probleme e ngjarje të rëndësishme, por që, pavarësisht nga titulli e dimensioni, ato kanë lënë gjurmë të zbehta në kujtesën e spektatorëve, sic janë p.sh. «Mbledhja e Moskës» e Z. Shoshit, «Në plazh» e N. Jonuzit, «Drejt Vlorës» e

P. Cenos etj., të cilat në embrion mbartin ide të rëndësishme, por mbeten të pazhvilluara artistikisht. Është forma e përshtatshme dhe e fuqishme ajo që do të ushqejë dhe do të rrisë embrionin ideor, duke e kthyer atë në vlera të vërteta estetike.

Kërkimet për gjetje dhe forma të reja emocionale, për mjete të reja shprehëse në artin realist janë të lidhura gjithmonë me dëshirën e artistëve militantë që të realizojnë në figura artistike kërkesat e reja që sjell jeta, në vend të atyre që u kalon koha e vjetërsohen, duke shprehur kështu me emocioni të ri artistik kërkesat që ka populli e Partia për një art aktiv bashkëkohor. Vetë fakti që këto vitet e fundit në pikturën tonë të kavaletit vihet në një prije drejt krijimit të përfytyrimeve e zgjidhjeve monumentale, është shprehje e qëndrimit dhe preokupimit serioz që kanë piktorët për të dhënë me frymë e përmasa epike shndërrimet e mëdha që kryhen në vendin tonë në të tëra fushat e jetës ekonomike, shoqërore e kulturore.

ZEF SHOSHI

TË BËJMË NJË JETË MË INTENSIVE KRIJUESE

Piktorët tanë në veprat më të mira kanë mbajtur qëndrim krijues ndaj realitetit, duke shprehur me gjuhën e ngjyrave, kontrasteve e formave, qëndrimin e tyre ndaj ngjarjeve të revolucionit e të jetës sonë. Në këtë vështrim, rëndësi të veçantë merr gjetja

NJOHJA E JETËS – DOMOSDOSHMËRI PËR TË DHËNË TABLONË E EPOKËS SONË

dhe zgjidhja origjinale e linjës kompozicionale, të pa-përsëritshme, që zërthen më mirë idenë që dëshiron të shprehë autori. Vepra do të jetë më e bukur ron të përcaktuar shqiptare, që buron nga jeta dhe mjeditë përcaktuar shqiptare, që buron nga jeta dhe mjeditë përmendim këtu disa nga këto vepra, si tablotë «Punëtorët» të V. Kilicës, «Zëri i masës» të S. Shijakut, «Buka e duarve tonë» të S. Kamberit, «Barinjtë» të B. Asllanit, «Metalurgët» të C. Cekës «Punëtorët e kombinatit të autotraktorëve» të S. Shijakut dhe M. Fushekatin, «Në hidrocentralin E. Hoxha» të A. Mirukut, «Naftëtarët» të A. Shanit etj.

Këto vepra dallohen pér origjinalitetin e zgjidhjeve kompozicionale, duke dhënë bukur dhe në mënyrë emocionuese idenë dhe përbajtjen. Qëndrimi ide-oemocional i autorit është një ndër pikat më të rëndësishme pér krijimin e veprës. Kjo lidhet me frymëzimin e tij të vazhdueshëm nga jeta, të jetuarit me situatat dhe përpjekjet e popullit tonë, pér të çuar përpjekjet e revolucionit. Pra, kërkohet një tendosje e vazhdueshme e krijuesit pér të dhënë me mjete të goditura zgjidhjen artistike të veprës. Në procesin e punës krijuese alternohen fantazia artistike e krijuesit me mbresat e jetës. Vepra duhet të lindë si një nevojë e domosdoshme pér të shprehur e pér të thënë diçka. Përndryshe, puna me hope e me fushata, do të na japë vepra pa vlerë e të ftohta në emocion. Në këtë drejtim ndihet nevoja e një jete intensive krijuese, e shkëmbimit të përvojës e debatit, e rrahjes së mendimeve, që janë kaq të nevojshme pér nxitjen e punës sonë krijuese. Trashëgimia përparimtare e artit botëror duhet të vlejë si nxistje pozitive pér krim, përndryshe nga ndonjë krijues i cekët do të kemi plagjiaturë, që është kaq e dëmshme pér artin.

Krijimtaria janë artistike është rritur e pasuruar, si rezultat i rritjes dhe i fuqizimit të individualiteteve të veçanta artistike, ku secili e thotë fjalën e tij me zërin e veçantë, pa pasur nevojë të huazojë andej e këndej.

Në pikturën tonë të realizmit socialist janë krijuar vepra që meritojnë vëmendje, sepse në themel të tyre janë zbatuar parimet bazë të realizmit socialist, është trajtuar një tematikë, në shumicën dërrmuese aktuale, është forcuar origjinaliteti kombëtar e popullor, është forcuar përbajtja dhe është ngritur cilësia krijuese. Masat kërkijnë sot nga artet figurative vepra më të përkryera, me vlerë artistike më të lartë dhe, përbajtje më të shëndoshë. Këto kërkesa të masave, ne piktorët duhet t'i kuptojmë më thellë dhe t'i zbatojmë më mirë në krijimtarinë tonë.

Janë të gjitha mundësítë që në pikturën tonë të realizmit socialist të arrihet një cilësi më e lartë. Por kjo do të bëhet kur ne të futemi më thellë në gjirin e masave. Jeta jonë socialiste, trajtimi i saj me realizëm në gjinitë e artit figurativ, si në kompozim, në portret apo në peizazh, kërkon që të njihet jeta nga ne në tërë kompleksitetin e saj. Prandaj duhet që krijuesit të janë të përgatitur jo vetëm profesionalisht, por edhe me një kulturë të gjerë e të shumanshme, të njobin historinë, kulturën popullore, të njobin folklorin, tipa e karaktere, sepse krijojnë vepra që u shërbëjnë masave. Partia na quan ndihmësit e saj kur veprat tona ngrënë probleme dhe ndihmognë në formimin e botëkuptimit marksist-leninist, me kërkesa e kohës dhe të ndërtimit të socializmit.

Mendoj se, pa mohuar veprat që janë realizuar, ne jemi ende borxhlinj në plotësimin e kërkësave që ngre koha. Kemi vepra që sjellin në artet figurative temën e klasës punëtore dhe të fshatarësise kohës së sotme.

operativiste, por këto janë ende në fazat e zhvillimit, janë anësore. Nuk kemi të pasqyruar si duhet heroizmin masiv të rinisë sonë në ndërtimin e veprave mëdha, si të Lukovës, apo të hekurudhave, të hetë që udhëheqin me shembullin e tyre në punë, ronje që arsim, në shkencë e kudo.

Të marrim veprën e piktorit Danish Jukniu «Në hidrocentralin «Enver Hoxha»». Ajo ka një zgjidhje kompozicionale që nuk zbulon te masat e punëtorëve déshirën për arsim, nuk të jep aspektin e masivizmit të arsinuit, por shohim figura që qëndrojnë verticalisht dhe nuk të shpien më tej.

Piktori Rafael Dembo në eksposítën e tij kishte dy peizazhe nga Plasa. Edhe këto ishin anësore, nuk trajtonin ndonjë ide si atë të sakrificave e heroizmit të kooperativistëve në realizimin e detyrave bujqësore.

Është e kuptueshme se krijimtaria në artet figurative do të pasqyrojë gjithë anët më interesante të jetës sonë socialiste, por nuk duhet të harrojmë atë që mbetet si një detyrë bazë — plotësimin e tablosë së epokës së socializmit në Shqipëri.

DRITËRO AGOLLI

PIKTURA JONË DO TË NJOHË ARRITJE TË REJA

Në këtë plenum ne po diskutojmë gjërisht përikturën, e cila ka arritje të ndjeshme, që nuk i errësojnë aspak vërejtjet që po bëhen këtu dhe kërkesat që po shtrohen. Këto arritje duken veçanërisht në pas-

qyrimin e jetës dhe natyrës së vendit tonë, të luftës dhe punës së njerëzve. Në pikture dalngadale po bëhet gjithmonë dhe më i plotë portreti i Shqipërisë. Në peizazhet, portretet, tabloët e grafikat shprehët dashuria për Atdheun, patriotët, partizanët dhe bashkëkohësit tanë. Sot anembanë Shqipërisë punojnë e krijojnë shumë piktorë, të moshuar dhe të rinj, me ndjenjën e përgjegjësisë së piktorit militant. Në punë krijuese janë afirmuar personalitetë të shquar artistësh, të cilët me veprat e tyre luajnë rol të rëndësishëm në edukimin e njerëzve me shije të përparuara estetike, me dashurinë përvendin, me dashurinë përsocializmin. Por hapat e këtij përparimi kanë nxjerrë edhe disa probleme që duhet të na bëjnë të mendojmë.

1. Është e domosdoshme të luftojmë skematizmin në pikture, i cili, në fund të fundit, është një subjektivizëm, pasi e bën jetën skemë, e varfëron atë. Skematizmi është steril, është pa pjellori. Ai krijon disa shtampa që përsëriten, e zbukuron realitetin dhe me këtë ia heq lëngun pikture, si thatësira lëngun e pemëve. Duhet cliruar piktura nga fraza konvencionale, domethënë nga kompozimi konvencional i figurave të buzëgreshura, të krekosura, të zbukuruara nga krenaria pompoze, pa mendim të thellë.

Skematizmi krijon monotonji, krijon një mënyrë të ngrirë të vendosjes së figurave pa peshë, të figurave që duken të lehta si pendë, që nuk vijnë erë materiali, erë jete. Ai është i rrezikshëm pasi përhapet si gripi në të gjithë pikturen tonë, përhapet më shpejt se në letërsi përvetë specifikën e arteve figurative. Skematizmi në pikture, siç duket shpejt, me një vështrim, ashtu edhe përhapet shpejt dhe futet menjëherë në mes të kornizave. Prandaj rrufeshëm duhet luftuar, që të mos na bëhet mënyrë jetese në krijimtari, që të mos na bëhet zakon.

2. Krahas skematizmit, të luftojmë fotografimin e jetës që është në të vërtetë një kopjim i natyrës dhe i veprimeve të njerëzve. Fotografimi ndryshon nga skematizmi në moslodhjen e mendjes, pasi çdo gjë e gjen në natyrë. Skematiku e lodh mendjen për të krijuar skema. Fotografiku kopjon dhe lodhet vetëm nga të kopjuarit nëpër fotografi dhe në natyrë. Edhe skematizmi, edhe fotografimi ndodh që pranohen nëpër eksposita, pasi nuk kanë «gabime». Janë mediokri. Mediokri nuk bën asnjë «gabim», ai është vetëm mediokër.

Edhe skematizmi, edhe fotografimi luftohet kur të kemi një kulturë të gjerë dhe një fantazi prej krijuesi. Piktorevê herë-herë u mungon fantazia, prandaj foto grafojnë. Realiteti nga artisti rikrijohet dhe nuk fotografohet. Prandaj është e domosdoshme të jemi novatorë dhe t'i shtojmë kërkesat për novatorizëm. E theksoj këtë pasi vitet e fundit e kemi humbur interesin për novatorizëm dhe bëjmë siç kemi bërë, ecim siç kemi ecur. Mjetet shprehëse nuk i kemi ripërtërirë dhe nuk i kemi revolucionarizuar, kemi ato mjete që na kanë lënë të parët. Kjo na ka ambientuar me mesataren. Kur nuk ka kërkime novatore, ka ecje të pandjeshme mes ambientimit. Kështu që pikturat tonë nuk ngjallin debat, nuk të bëjnë të mendohesh. Një pikturë nuk e kundërshtojnë me zjarr kur paraqitet në eksposítë dhe as e pranojnë me zjarr. E kundërshtojnë me hi dhe e pranojnë me hi! Në karikaturë çështja qëndron pak më ndryshe. Ajo ka më shumë fantazi se piktura, prandaj ngjall diskutime dhe vështrohet me kuriozitet. Eksposítat e karikaturës janë të një niveli të ngritur dhe ndiqen me interes nga vizitorët. Prandaj nga fantazia dhe mjeshteria e karikaturës kanë ç'të mësojnë edhe piktorët, bile edhe poetët.

3. Të luftojmë më shumë që të prishim disa zakone
dhe disa rite në krijimin dhe në pranimin e pikturës.
Këto rite janë kërkesat didaktike për pikturen, se si
ajo duhet të jetë, se si duhet ta ketë dorën figura, se
si duhet ta ketë hundën, veshët, sytë e shpatullat, apo
palët e pantallonave. Këto rite didaktike nuk lejojnë
që të hyjë jeta sa më e plotë e konceptuar filozofi-
kisht, përmes një mendimi më të thellë; të hyjë aktua-
liteti historik, puna dhe jeta e njeriut. Kjo jetë nuk
duhet të hyjë në mënyrë diskriptive në mënyrë
pëershkruese. Të pasqyrosh aktualitetin, nuk do të
thotë të pikturosh çdo gjë, edhe një veprim të çastit, si
spërkatjen e vreshtave, heqjen e plehut nga stallat,
ngarkimin e kafshëve etj. Nga realiteti do të marrësh
atë çast që të jep mundësi të ngjallësh një mendim. Dhe
ky mendim nuk jepet duke i bërë figurat si fotografi,
me simetri të plotë. Më duket se në pikture vuajmë nga
pikturimi i plotë, nga një pikturim që duken edhe kop-
sat nga larg, që duken qimet, që duken qostekët. Në
qoftë se nuk e ka një pikture këtë simetri dhe këtë
imtësi, ndodh që nuk e pranojmë në ekspozitë. Ne,
pranuesit, nuk e kemi pra të qartë destinacionin e pik-

turës, e kërkojmë të vërtetë si fotografi. Të vërtetën e pikturës e kërkojmë si të vërtetën e fotografisë. Ne kërkojmë nga një lopë e piktuuar aq realizëm sa të dalë nga korniza e pikturës, ta mjelim dhe të mbushim kusinë me qumësh. Ky mentalitet i administratorëve, i pranuesve dhe i vlerësuesve të pikturës, ka ndikuar keq dhe ka formuar një stil, një prirje, një mënyrë pikturiimi drejt një vërtetësie vulgare. E bëj këtë vërejtje, pasi nuk duhet të edukojmë shije estetike vulgare në popull. Njerëzit me këtë lloj arti mësohen dhe pastaj nuk rimësohen aq lehtë me atë çka është me të vërtetë novatore.

4. Përshtatja me një mënyrë të pikturuari ka influencuar edhe në forcimin e zakonit të një lloj pune, të punës vetëm për eksposita dhe jo të asaj pune të përditshme si kërkesë shpirtërore. Mjaft piktore nuk kanë piktura në studio e në shtëpi. Rrjedhimisht duhet të prishim ritin apo zakonin që na është krijuar me kohë. Të vjen keq që edhe piktore të shquar dhe skulptorë me emër si Sali Shijaku, Myrteza Fushekati, Skënder Kamberi, Danish Jukniu, Ismail Lulani, Kristaq Rama apo Mumtaz Dhrami, shpesh, punojnë në kohë ekspositash apo angazhimesh të mëdha dhe nuk punojnë sa duhet ditë për ditë edhe për kënaqësi të tjera shpirtërore. Me një fjalë, ne duhet të bashkojmë dy lloje punësh në një të vetme, të punës për eksposita me punën e përditshme. Sot edhe puna prodhuese është shndërruar në krijimtari, pasi ngjall kënaqësi shpirtërore, se është e çliruar. Aq më tepër piktura duhet t'i ngjallë piktoret kënaqësi shpirtërore. Duke punuar ditë për ditë me kënaqësi shpirtërore, piktura do të hyjë më shumë nëpër shtëpitë e popullit, nëpër shtëpitë tonë.

5. Hyrja e piktureš në shtëpitë tona ka një rëndësi të veçantë. Ajo e mëson njeriun tonë ta dojë të bukurën dhe në jetesën e tij të hyjë e bukura. Socializmi e do të bukurën dhe duhet të jetë domosdø më i bukur se çdo rend tjeter shoqëror. Artet e tjera, letërsia, muzika, gdhendjet dhe qëndrismat kanë hyrë gjëresisht në shtëpitë tona. Nuk ka shtëpi pa libra e pa këngë. Kurse shtëpi pa pikture ka. Nuk duhet ta lemë pikturen vetëm në eksposita. Por që të mos e lemë vetëm në to, duhet të bëjmë pikture të mirë e të larmishme, dhe me dimensione të ndryshme, jo vetëm me përmasa të mëdha, pasi nuk e nxenë muret e dhomiave tonante.

Piktura janë do të njohë arritje të reja. Ne kemi piktorë të talentuar, piktorë me shkollë e me kulturë. Vërejtjet aspak nuk i errësojnë arritjet. Tani me optimizëm duhet të punojmë për të shkuar në 45-vjetorin e themelimit të Partisë me veprimitari të nivelit të lartë.

FATMIR HAXHIU

JO PAMJE ANËSORE, POR VEPRA KOMPOZICIONALE QË JAPIN ME GJERËSI DHE THELLËSI EPIKË E LUFTËS

Veprat që kanë pasqyruar momente kyçë të historisë së Luftës Nacionallirimtare, nuk kanë munguar, por duhet thënë se përsëri ato janë të pakta dhe nuk mund të krijojnë një përfytyrim të plotë të asaj epopeje madhështore. Këtu është fjala për tablo të tilla, në të cilat, me momentet që pasqyrojnë, me gjerësinë dhe thellësinë epike, të jenë dhënë me një sintezë të fuqishme heroizmi masiv dhe individual, dashuria e madhe për atdheun dhe besimi i patundur për të ardhmen. Këtë kërkesë të domosdoshme nuk mund ta plotësojnjë sadopak ato kompozime, të cilat jepin pamje anësore, të shkëputura, të papercaktuara në kohë dhe hapësirë, pa vlera përgjithësuese. Duhet theksuar se edhe këto tema janë të nevojshme për të plotësuar imazhin e gjërëtë luftës, po në asnjë mënyrë këto nuk

mund të zëvëndësojnë dhe të luajnë atë rol që kanë tablotë e mëdha epike, me ide thelbësore. Aq më pak mund të luajnë këtë rol kompozimet që nuk kanë rezonanca ideore e artistike, por mbeten thjesht në fotografimin e një çasti të rëndomtë, i cili na bënë të kuptojmë luftën vetëm nga rekuizita. Ka mjaft kompozime që na jepin fragmente marshimi partizan, por këtu, duke mos kapur më vërtetësi psikologjinë, atmosferën dhe gjendjen reale të luftës, të krijohet përshtypja sikur shikon një ekskursion të rinisë të ditëve tona. Në vepra të tilla, ku shohim partizanë me qëndrime pompoze e teatrale, nuk ndihet heroizmi i vërtetë, mundimi, lodhja, uria, pagjumësia, qëndresa dhe shpirti i sakrificës etj.

Dobësi dhe të meta të tilla rrjedhin sa nga një konceptim estetik i cekët, po aq edhe nga njohja e pakët, e sipërfaqësore e realitetit të luftës apo historisë sonë. Ky është një problem tjetër që duhet të trajtohet nga kritika janë artistike.

Mosnjohja të çon në naivitetë të thella, sa të shohim kompozime ku tanket të çajnë në majë të maleve. Vihet re edhe në letërsi, por e shohim edhe në pikture dhënien e një armiku të frikshëm e të fuqishëm, fjala vjen si te tabloja «Fundë i armikut», B. Lucës, gjë që nuk i përgjigjet të vërtetës.

Në raport dhe në diskutime ngrihet nevoja e kritikës si domosdoshmëri për rritjen cilësore të krijimtarisë. Tani më tepër se kurrrë kemi nevojë për një kritikë që të trajtojë jo vetëm probleme të përgjithshme të krijimtarisë artistike, por edhe studime për vepra e autorë të veçantë, që ndikojnë në gjithë krijimtarinë. Kemi nevojë për rrahje mendimesh e sa më shumë debat në shtyp, për të krijuar një opinion të qartë si për masat e gjera, po edhe për vetë autorin.

Për debatin në shtyp është folur shumë herë. Partia gjithmonë e ka ngritur këtë si një problem të veçantë dhe të një rëndësie të madhe për të ecur përpara, por përfat të keq, ende edhe sot nuk po çahet. Këtu nuk është fjala për polemikë shterpë, por për rrahje mendimesh konstruktive mbi baza të shëndosha e qëllim-mira.

Mbetja të një opinion, për një ekspozitë kombëtare ku marrin pjesë më shumë se 400 autorë, jo vetëm që s'është e drejtë, por s'mund të jetë as e saktë, si për

veprat e kritikueshme, ashtu edhe për ato që lavdë-rohen, aq më tepër që shkrimet, për ekspozita të tilla kanë më tepër karakter pasqyrues e manifestiv, sesa studimor e për të ngritisur probleme.

AGIM FAJA

KËRKESA MË TË MËDHA NDAJ GJINISË SË PEIZAZHIT

Pasqyrimi i akutalitetit tonë socialist presupozon një interpretim të bukur e të plotë të peizazhit tonë të ri, të minierave, uzinave, kantjereve, kombinateve, të qyteteve tona të reja e të natyrës së transformuar. E ky interpretim duhet të jetë sa më emocional e sa më i ndryshëm, me shprehje të thellë artistike. Kur piktori, si një poet i vërtetë, zgjedh motive të thjeshta, për të krijuar një vepër të thellë, duke i njojur dhe studiuar gjerë mjediset e natyrës, ai sjell imtësi, detaje, fakte e mbresa origjinale, bile edhe kur trajton të njëjtin motiv, ai zbulon gjithnjë nuanca të reja. Në gjithë arritjet e deritanishme, ndeshim raste kur kjo tematikë nuk ka gjetur shprehjen e duhur.

Këtu ka shumë rëndësi botëkuptimi i artistit dhe gjëllimi që e udhëheq atë. Ai e koncepton natyrën gjithnjë në marrëdhënje me njeriun, e pikërisht mbi këto marrëdhënje të holla dhe emocionale, bile dhe poetike, e trajton atë në gjithanshmërinë e saj. Artisti i vërtetë nuk e koncepton kurrë natyrën si një trup inorganik. Piktori, nëpërmjet natyrës, pasqyron pikëpamjet e veta, shpreh botëkuptimin e tij.

Peizazhet që evokojnë historinë dhe kanë si motiv vende që lidhen me ngjarje historike, është e natyrshme që të kenë një konceptim, një këndvështrim dhe një kolorit adekuat, se marrin përsipër misionin e një peizazhi përgjithësues, me një mendim më të gjerë e të gërshetuar. Tentativa të mira janë bërë nga Foto Stamo me «Malin e Tomorrit», nga Sali Shijaku me «Shtëpinë ku u themelua Partia», nga Kujtim Buza e Bashkim Ahmeti me peizazhin «Gjirokastra», nga Nestos Jonuzi me peizazhin «Deti» etj. Megjithatë, në eksposizitat tona jemi ndeshur edhe me peizazhe që nuk kanë arritur ta thonë ashtu si duhet fjalën e tyre, por kanë qenë të zbehta, pa nerv e pa qëndrim krijues.

Për piktorin koloriti është një problem tepër i rëndësishëm që, po të mos arrihet, i dobëson idenë. Ndodh shpesh që piktorët më të dhëna të ndryshme koloristike, kur shkojnë në vepra industriale, i bëjnë të njëllojta peizazhet, bile ndodh që i njëjti piktor bën njësoj, me të njëjtën gamë koloristike, edhe Metalurgjinë, edhe Komanin edhe minierën, edhe portin.

Dihet që e bucura qëndron në forcën e të shprehurit, ndaj edhe peizazhet që kanë një përbajtje të thellë socialiste, janë vepra të plota. Piktori i vërtetë përpinqet të njohë gjeografinë dhe historinë e atij vendi ku vendos të punojë, të njohë njerëzit, botën e tyre shpirtërore. Ai nuk duhet të bëhet turist, e të mbledhë motive të sipërfaqshme, etyde të bazuara në kujtesë. Kujtesa është vërtet një element i rëndësishëm i pasqyrimit, por kurrrë nuk është gjithçka.

Në ambientet tona socialkulturore po futen gjithnjë e më shumë vepra arti e, në mënyrë të vecantë, peizazhet. Është e udhës që këto punime piktorët t'i bëjnë me po atë përgjegjësi, siç i përgatisin për në eksposizitat kombëtare apo vetjake, që të kenë vlera të vërteta artistike dhe edukuese.

Piktori peizazhist, duke ndjekur hap pas hapi shndërrimet që ndodhin në jetën e popullit tonë, do të jetë në gjendje jo vetëm të pasqyrojë realitetin, por edhe të rrisë frymën militante. Vetëm një punë e tillë do të ngrëjë cilësinë e veprave tona në këtë gjini, do tu kundërvihen peizazheve mediokre dhe mesatare, që zënë vend ndonjëherë në ambientet tona dhe që i shohim ende nëpër ekspozita.

TË NGREMË TËRË PUNËN TONË KRIJUESE NË NJË SHKALLË MË TË LARTË

Edhe në pikture, si rezultat i preokupimit më të madh për trajtimin e problemeve të rëndësishme aktuale, duke zbërtyer mirë dhe bukur emocionalisht ato gjetje artistike që u përgjigjen ritmeve të zhvillimit të jetës, deshirave dhe aspiratave të masës, janë krijuar vepra në gjinitë e kompozimit, portretit dhe peizazhit, që u kushtohen transformimeve në jetën tonë socialiste.

Por me gjithë arritjet, kur detyrat edhe të artistëve të artit figurativ janë rritur si rezultat i kërkesave dhe nivelit kulturor të masave tona punonjëse, kur është shtuar përgjegjësia jonë për edukimin ideo-estetik të tyre me idealet e larta komuniste, fryshtë militante dhe shpirtin krijues, me mendimin më të përparuar bashkëkohor, rrjedhimisht edhe puna e jonë duhet të ngrihet në një shkallë më të lartë. Lufta ndaj shfaqjeve të skematizmit dhe dukurive të tij duhet të bëhet përmes një pune të vazhdueshme dhe sistematike, thellimit më tej, në mësimet e Partisë dhe veprën e pavdekshme të shokut Enver, njohjen e jetës dhe përkryerjen e mjeshtërisë artistike, rritjen e nivelit kulturor, kuptuar kjo si kulturë libri, jete dhe të fshehtësive të zanatit.

Disa punime përsërisin me mjete më të varfra artistike skena të njohura më parë, tablo që ripërsërisin rrugë të shkelura dhe të konsumuara. Një grup tjetër veprash riprodhojnë në mënyrë të përciptë skena të rastësishkme, episodike, dhe fragmentare, përsëritje të rëndomta fotografish apo qëndrimesh fotografike. Hasen të tjera vepra, që tregojnë në mënyrë letrareske dhe përshkruese plot detaje të tepërtë, episode, duke

harruar kështu karakterin lakonik dhe të kursyer që kanë natyrën e tyre artet figurative, Kështu, puna kthehet në një tabelë mësimore, p.sh., shpjegon se si korret gruri, por nuk zbulon gjëzimin e jetës, gjëzimin e bukës së re, të begatisë. Skematike tingëllojnë edhe rastet e thjeshtëzimit të problemeve dhe mungesa e thellimit në modelimin e detajit të domosdoshëm, mbajtja e tepruar pas sipërfaqeve të sheshta dekorative; ashtu edhe kur vepra mbushet me gjithfarë detajesh që e kthejnë tablonë në «magazinë» plot çështje... Përsëritje e të njëjtave mjete shprehëse në mënyrë standarte, nuk ka të bëjë me individualitetin, originalitetin, shpirtin krijues, përkundrazi, me rutinë, uniformitet, mungesë orginaliteti, manierizëm që skematizon idenë e veprës. Skematizëm kemi edhe në ato raste të keqkuptimit të dinamizmit përmes lëvizjesh të pagjetura e antiestetike, teatrale, gjeste që banalizojnë përbajtjen. Por skematizëm kemi edhe në rastet kur komponentet përbërëse të arsenalit të pikturez nuk gjejnë raport të drejtë, mes tyre, kur ngjyra nuk lidhet me vizatimin apo ndërtimi vizatimor nuk ngjeshet me koloritin për të krijuar atë gjendje të përcaktuar emocionale. Pompoziteti dhe llamburitjet artificiale koloristike, dimensionomania, rritja jashtë logjikës së përmasave, sikundër dhe minimizimi i tyre, e zbehin dhe nuk e ndihmojnë thellimin e problemeve që preokupojnë artistin.

Arti ynë i realizmit socialist e ka në natyrën e vet karakterin novator dhe original, që buron nga përbajtja dhe zbulimi filozofik dhe artistik i asaj substance nga fillon realizimi i veprës. Mirëpo, ashtu sikundër ngathtësia, monotonia, kollajllëku, uniformiteti, manierizmi, sjellin skematizëm dhe mediokritet, po ashtu edhe përpjekja e ndonjërit për t'i shpëtuar këtij skematizmi duke keqkuptuar guximin krijues dhe cilirim nga skematizmi me shfaqje diletanteske, spontane e naive, me përpunim të formës si qëllim në vete, nëpërmjet përdorimit të groteskut dhe të lëvizjeve pa kuptim të figurave dhe gjymtyrëve, me një konfuzion dhe organizim kompozicionali, kuptim të ngjyrave dhe koloritit thjesht si elemente të shkëputura, si dhe teprimet simbolike, gjithashtu, janë të papranueshme për artin tonë të vërtetë socialist.

Ky lloj skematizmi krijon jo vetëm një psikologji të ambientimit me mediokritetin dhe mesataren të vete krijuesit, duke i marrë atij fantazinë dhe preokupimin

krijues, atendosjen shpirtërore dhe synimin logjikë për të sjellëndigka, të re dhe të bukur, por kjo influencon dhe në ambientimin me këto kërkesa të komisioneve dhe porositësve të institucioneve kulturore artistike, të cilët gjithashtu kanë formuar shtampa dhe influencojnë negativisht, kur imponohen me «parafabrikatet» e tyre.

Prej shkaqeve dhe pasojave të këtyre shfaqjeve, sado të paktë, duhet të nxjerrim mësimë dhe të punojmë për të vënë në jetë porositë që ka dhënë vazhdimit të Partia për ngritjen e nivelit artistik, të këshillave që dha shoku Ramiz, kur vizitoi në hidrocentralin «Enver Hoxha» të Komanit ekspositizen e piktorit Ali Miruku, që të mësojnë nga cilësia e punimeve në këtë hidrocentral.

Viti i 45-vjetorit të themelimit të Partisë është një vit plot me aktivitete të rëndësishme edhe në lëmin e arteve figurative. Prandaj, të mobilizohemi dhe të rritim kërkesat për të realizuar me sukses veprat e rëndësishme monumentale dhe, veçanërisht, projektidetë për monumentet e shokut Enver, veprat e artit që do të fillojnë për Muzeun «Enver Hoxha» dhe disa veprat tjera të piktureve dhe skulptureve monumentale, dekorative dhe të kavaletit; veprat për Ekspositizen Komitetare të arteve figurative dhe atë të arteve të aplikuara e të kulturës popullore.



«Parti-Enver»

45 VJET PARTI E PUNËS

45. VET PARTIE PUNÈS

Frymëzimet e Partisë

dhe krijimi i veprave letrare-

artistike

etiamvis i' dicitur quia est ep' p'f' s'c' p'f' q'nt' p'f' q'nt'

éste se considera que es de menor importancia que el de la actividad económica.

STUDIO OF ACTS

STERJO SPASSE

Ép ánni svín eftir að ófins eru fyrir hvernig fer að flokkast með meðaltíði Ép, eða ekki er að ófins eru ófins með meðaltíði.

12 Melancholia regnatur, tamquam regis sacerdotum et regis
eiusdem regni, ut regis regnum regnaret, et regis regnum regnaret.

EPOKE QÈ MÈ NDRICOI

LUDHEN EKRUUMTAARISE

UDEN E KRIMI TAKISE

здесь же субстраты и мицелии грибов, а в зоне

Jubileu i 45-vjetorit të themelimit të Partisë sonë

lavdimadhe është një jubile festash ngadhnjyese në
edo fushë përmbarë populim tonë. I tillë është edhe

pér letërsiné e pér artet tona, të cilat jo vetém që kanë
qenë artistë, por edhe artistike përfshirë si iku por me kri-

arritur kume ideo-artistike ne çdo gjihe, por meje KTH-jimet më të mira jepin ndihmësën e cmuar edhe në pa-

sürimin e letérsisé e té artit perparimtar té perbotshém die pohojnë vitalitetin e metodës së realizmit socialist.

Prandajky jubile na ndjell më të mirën e më të mbarë, që sedhe ne shkrimtarat e artistëve më të mosqituar.

te shohim konkrètisht procesin e zhvillimit të krijuar

371986-76 53

gjatë sonë që nga ndikimet e rrymës romantiko-sentimentale në metodën e realizmit kritik dhe në përqafimin me bindje të plotë të metodës së realizmit socialist, kurdoherë të udhëhequr nga mësimet e mëdha list, largpamëse dhe nga dashuria e thellë e Partisë sonë.

Po marr veten time: Krijimi im i parë mban datën e vitit 1929, një shkrim në revistën «Normalisti». Kam qenë vetem 15 vjeç dhe nuk mund të flas për interesat e parë të mirëfilltë e të qartë, jo vetëm pse isha shumë i ri, por edhe pse kisha pak njohuri për jetën kulturore të vendit e të përbotshme. Interesat e parë rrithnin nga pasioni për letërsinë dhe nxiteshin nga fëksimi i disahershëm i shkrimitarëve të Rilindjes sonë, nga dashuria për folklorin, që ishte shumë i zhvilluar brigjeve të Prespës, ku kam lindur, nga nxitja e mësuesve të shkollës plotore të Korçës e sidomos të shkollës Normale të Elbasanit me prof. Aleksandër Xhuvanin në krye e me botimin e revistës «Normalisti» nga vete nxënësit. Mësimi i ndonjë gjuhe të huaj më hapi dritare të reja për t'u njohur më mirë me thesarrët kulturore të popujve të tjera. Interesohesh ka edhe për botën e tejoqeaneve me anën e njerëzve tanë, që shkonin për të kërkuar krohdhën e bukës e që ktheheshin të firosur edhe nga xhepi, edhe nga shëndeti. Si në rrethin e Korçës, ashtu edhe në Elbasan si nxënës e më vonë si mësues në rrethin e Gjirokastrës e të Korçës spikaste sundimi feudo-borgjezi i kohës, por edhe revoltë kundër këtij regjimi dhe jo vetëm në Korçë, por edhe në fshatra ku vepronte Grupi Komunist. Sidomos vendlindja ime ishte shtypur në mënyrë më gjenerozore nga bejlerët, nga fajdexhinxhjet e nga qeveritarët. Por edhe rezistenca e fshatarëve kundër tyre ka qenë e fortë, veçanërisht ajo e fshatarëve të Goricës. Këto të gjitha më krijuan bindjen se atdheu ynë ishte shumë i prapambetur e shumë i varfër e i shtypur dhe se në krye të punëve ishin «hajdutë me çizme», sic që sendisëshin më dhimbje fshatarët. Patafatin në Korçë, në 1932, na takojë disa herë militantë komunist Ali Kelmendi, që pat këshilluar shpesh: «Shkruaj vetëm të vërtetën, hidh në kartë vetëm të vërtetën». Nga ketotatë gjitha u binda se edhe unë mund të kontribuoja me punën time për përmirësimin e jetesës së masës së dashkës fshatarëve e të bashkëqytetarëve tanë. Kur ishnikxenes nënshkollen Normale, jam marrë me publikisht duke shkruat për zhvillimin e për problemet ar-

simiore të rinisë e kundër zakoneve prapanike etj, madje edhe tregime më shumë nga jeta e fshatit. Më 1935 bota romanin tim të parë «PSE?...» duke bërë përpjekjen e parë për tu shfryrë në një gjini të gjéré ndaj kësaj gjendje dramatike të kohës. Përpjekesa të pasqyrja «të vërtetën e kohës» dhe këtë të vërtetë e shihja te kaosi i rinisë intelektuale shqiptare të papërspektivë e të revoltuar në mënyrë konfuze kundër rendit feudo-borgjezë dhe kundër zakoneve dhe mëntalitetave prapanike të fshatit e të qytetit, por nuk arrija të gjeja rrugëdaljen ideoartistike, sepse vëtvrasja e protagonistit nuk shpinte në shërimin e plagëve të kohës. Megjithatë protagonisti Gjon Zaveri, edhe pse i narkotizuar në mënyrë të pashërueshme, në testamentin e vet me bindje të plotë dënon rrugën «evrasëve», siç është filozofët idealistë dhe u rekomandon rinisë, që të mos i ndjekin.

Më vonë veç mjaft tregimeve, shkrova edhe romanin «Afërdita» që është për muaj si një urë kalimi nga botëkuptimi pesimist revoltues i romanit «PSE!», në botëkuptimin e realizmit kritik.

